FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 263

Tiranë – E mërkurë, 11 janar 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 131/2016 datë 22.12.2016	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar	27237
Ligj nr. 132/2016 datë 22.12.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 53/2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar.....	27238
Ligj nr. 133/2016 datë 22.12.2016	Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë.....	27240

LIGJ
Nr. 131/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9662, DATË 18.12.2006, "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 hiqet fjala "kujdestarinë".

Neni 2

Në nenin 4, pikat 36, 37 dhe 49 shfuqizohen.

Neni 3

Në nenin74, pika 2, shkronjat "ç", "e", "ë" dhe "f" shfuqizohen.

Neni 4

Në nenin 81, shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:

"e) Krijimin e grupit mbikëqyrës, i cili vlerëson përgatitjen e bankës për kalimin në fazën e likuidimit. Krijimi, funksionimi dhe detyrat e grupit mbikëqyrës përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.".

Neni 5

Nenet 81/1, 81/2, 81/3 dhe 81/4 shfuqizohen.

Neni 6

Në nenin 89, shkronja "ç" e pikës 4 dhe pika 7 shfuqizohen.

Neni 7

Në nenin 91, pika 2, hiqen fjalët "kujdestarit dhe".

Neni 8

Në titullin e kreut VII hiqen fjalët "Kujdestaria dhe".

Neni 9

Nënkreu I, i kreut VII, shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 108, pika 1, shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:

"e) kur ekzistojnë kushtet e pikës 3, të nenit 25, të ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë".

Neni 11

Në nenin 114, pika 1, hiqen fjalët "kujdestarit ose".

Neni 12

Në nenin 121, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Në rast të likuidimit të bankës ose degës së bankës së huaj, detyrimet e pretenduara, të siguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, barrë siguruese ose kolateral financiar, shlyhen sipas vetë kushteve të parashikuara për këtë qëllim, kurse detyrimet për pretendimet e tjera të pranuara shlyhen me preferencë ndaj të gjitha detyrimeve të tjera, sipas radhës së detyrimeve të pretenduara, si më poshtë:

a) shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme, të bëra nga likuidatori, Banka e Shqipërisë (Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme) dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të legjislacionit në fuqi për sigurimin e depozitave dhe legjislacionit në fuqi për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë në lidhje me zbatimin e instrumenteve ose kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose të një instrumenti të mbështetjes financiare publike të jashtëzakonshme;

b) kreditorët e kredive të reja të dhëna bankës ose degës së bankës së huaj pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe emërimit të likuidatorit;

c) depozitat e siguruara të pakompensuara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave ose Agjencia e Sigurimit të Depozitave për pagesat e depozitave të siguruara, të cilat cedojnë të gjithë tagrat dhe të

drejtat e depozituesve të siguruar, të cilët janë kompensuar nga skema e sigurimit të depozitave;

ç) pjesa e depozitës së sigurueshme të individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare, e cila tejkalon nivelin maksimal të mbulimit nga skema e sigurimit të depozitave, si dhe depozitat që nuk kanë përfituar sipas shkronjës "c" të këtij neni;

d)detyrimet e pasiguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, barrë siguruese ose kolateral financiar;

dh) detyrime të nënrenditura, të cilat përmbajnë klauzola kontraktore për përcaktimin e tyre në këtë radhë të shlyerjes së detyrimeve, si dhe përmbajnë kushte të tjera, të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë;

e) instrumentet e kapitalit të pasiguruara me mjete të ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve, barrë siguruese ose kolateral financiar, dhe të cilat nuk janë aksione;

ë) detyrimet ndaj aksionarëve që rrjedhin nga pronësia mbi aksionet.".

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9934, datë 9.1.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 132/2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 53/2014, "PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 53/2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 7 shfuqizohet.

b) Shkronja "a", e pikës 19, ndryshohet si më poshtë:

"a) pjesëmarrja e Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë;".

c) Paragrafi i fundit, i pikës 19, ndryshohet si më poshtë:

"Ngjarja e sigurimit konsiderohet se ndodh në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë për vendosjen e subjektit anëtar të skemës në likuidim të detyruar ose të vendimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në bankën anëtare të skemës.".

ç) Pikat 20 dhe 26 shfuqizohen.

d) Pas pikës 34 shtohet pika 35 me këtë përmbajtje:

"35. "Ndërhyrje e jashtëzakonshme" është procesi i përcaktuar në ligjin "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë".".

Neni 2

Në nenin 8, pika 2, shkronja "c", fjala "kujdestarinë" zëvendësohet me fjalët "ndërhyrjen e jashtëzakonshme".

Neni 3

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 6, fjala "kujdestari" zëvendësohet me fjalët "ndërhyrje e jashtëzakonshme".

b) Në pikën 8, fjalët "e kujdestarisë" zëvendësohen me fjalët "e ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

c) Në pikën 10, fjalët "të kujdestarisë" zëvendësohen me fjalët "të ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

Neni 4

Në nenet 21, pika 3, dhe 65, pika 3, fjala "kujdestari" zëvendësohet me fjalët "ndërhyrje e jashtëzakonshme".

Neni 5

Në nenin 30, pika 1, shkronja "b", fjala "ndërhyrjen" zëvendësohet me fjalët "ndërhyrjen e jashtëzakonshme".

Neni 6

Në nenin 36, pika 1, shkronja "a", fjalët "të transferimit të mjeteve financiare në shitjen e bankës ose themelimin e bankës urë nga Agjencia," zëvendësohen me fjalët "pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë"".

Neni 7

Në nenin 38 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalia e dytë, e pikës 1, hiqet.

b) Në pikën 7, fjalët "ose të pjesëmarrjes së Agjencisë në shitjen e bankës ose bankën-urë" zëvendësohen me fjalët "ose të pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë"".

Neni 8

Neni 40 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 42 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 7, fjalët "si dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë në shitjen e bankës e krijimin e bankës-urë" zëvendësohen me fjalët "si dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë"";

b) Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8. Fondet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin e depozitave, nuk mund të bllokohen, të sekuestrohen apo t'i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm, përveç qëllimit për të cilin janë krijuar.".

Neni 10

Në nenin 43, pika 1, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja "gj" ndryshohet si më poshtë:

"gj) merr pjesë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";".

b) Shkronja "j" shfuqizohet.

c) Pas shkronjës "m" shtohet shkronja "m/1" me këtë përmbajtje:

"m/1) administron fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";".

ç) Shkronja "nj" ndryshohet si më poshtë:

"nj) përfiton financime shtesë, në veçanti për kompensimin e depozitave të siguruara ose për pjesëmarrjen e Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";".

Neni 11

Në nenin 52, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "t" ndryshohet si më poshtë:

"t) vendos për kthimin e fondit të kompensimit të depozitave në mjete likuide, për të përmbushur detyrimet ndaj depozituesve të siguruar, në rast ngjarjeje sigurimi, si dhe për pretendimin e Agjencisë për tagrat e ceduara nga kompensimi i depozituesve;".

b) Në shkronjën "u", fjalët "dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë në shitjen e bankës dhe krijimin e bankës-urë" ndryshohen me fjalët "dhe të pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë"".

Neni 12

Në nenin 60 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) pjesëmarrjen e Agjencisë me transferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";".

b) shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative për zbatimin e procesit të

kompensimit, sipas neneve 38 e 39, të këtij ligji, si dhe për pjesëmarrjen e Agjencisë me tranferim mjetesh financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";".

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9935, datë 9.1.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 133/2016

PËR RIMËKËMBJEN DHE NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME NË BANKA, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

SEKSIONI 1
OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është:

a) përcaktimi i rregullave, i procedurave dhe i instrumenteve për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka dhe degët e bankave të huaja;

b) përcaktimi i kompetencave dhe i detyrave të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të autoritetit mbikëqyrës;

c) krijimi, financimi dhe përdorimi i fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe administrimi i tij.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka dhe degët e bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrator" janë anëtarët e organeve të administrimit të bankës.

2. "Aksionarët" janë personat, të cilët zotërojnë aksionet ose instrumente të tjera të pronësisë.

3. "Agjencia e Sigurimit të Depozitave" ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

4. "Anulim" është përfundimi i çdo pretendimi financiar dhe të drejte pronësie mbi aksionet ose titujt e borxhit.

5. "Bankë" ka të njëjtin kuptim, siç është përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

6. "Bankë mbizotëruese" ka të njëjtin kuptim, siç është përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

7. "Bankë urë" është një person juridik që përmbush kërkesat e parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

8. "Bazë e konsoliduar" është konsolidimi i pasqyrave financiare, sipas përcaktimeve në

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me:*
- Direktivën 2014/59/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 15 maj 2014, "Mbi krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e institucioneve të kreditit dhe firmave të investimit, dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 82/891/KEE, dhe Direktivat 2001/24/KE, 2002/47/KE, 2004/25/KE, 2005/56/KE, 2007/36/KE, 2011/35/BE, 2012/30/BE dhe 2013/36/BE, si dhe Rregulloret (BE) nr. 1093/2010 dhe (BE) nr. 648/2012, të Parlamentit Europian dhe Këshillit", Numri CELEX: 32014L0059, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 173, datë 12.6.2014, faqe 190-348.

legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

9. "Degë e bankës" ka të njëjtin kuptim, siç është përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

10. "Degë e bankës së huaj" ka të njëjtin kuptim, siç është përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

11. "Derivativ" është instrumenti, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për titujt.

12. "Detyrime të siguruara" është një detyrim, ku e drejta e kreditorit për pagesën e çmimit apo për përmbushjen e detyrimeve në ndonjë mënyrë tjetër është siguruar nga një barrë, garanci ose peng apo marrëveshje kolaterali financiar, duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga transaksionet e riblerjes dhe marrëveshje të tjera të kolateralit për transferimin e titullit të pronësisë.

13. "Detyrime të pranuara" janë detyrimet dhe instrumentet e kapitalit, të cilat nuk kategorizohen si instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, të kapitalit shtesë të nivelit të parë ose të kapitalit të nivelit të dytë të një banke dhe që nuk janë përjashtuar nga objekti i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda në bazë të pikës 2, të nenit 31 të këtij ligji.

14. "Depozitë e siguruar" ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

15. "Depozitë e sigurueshme" ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

16. "Depozitues" ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

17. "Filial" ka të njëjtin kuptim, siç është përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

18. "Funksione me rëndësi kritike" janë veprimtaritë, shërbimet ose operacionet e një banke, ndërprerja e të cilave mund të sjellë ndërprerjen e shërbimeve që janë thelbësore për ekonominë reale ose të cenojë stabilitetin financiar për shkak të madhësisë dhe pjesës së tregut që ajo zë, ndërlidhjes së jashtme e të brendshme, kompleksitetit apo veprimtarive ndërkufitare të saj, duke marrë në konsideratë veçanërisht pamundësinë e zëvendësimit të këtyre veprimtarive, shërbimeve ose operacioneve në treg.

19. "Fondi i kompensimit të depozitave në banka" ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

20. "Grup bankar" ka të njëjtin kuptim, siç është përkufizuar në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

21. "Grup ndërkufitar" është një grup bankar, i cili përfshin subjekte të themeluara në më shumë se një shtet.

22. "Instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë" janë instrumentet e kapitalit, siç përcaktohen në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

23. "Instrumentet e kapitalit shtesë të nivelit të parë" janë instrumentet e kapitalit, siç përcaktohen në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

24. "Instrumentet e kapitalit të nivelit të dytë" janë instrumentet e kapitalit ose të borxhit të varur, siç përcaktohet në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

25. "Instrumente të pronësisë" janë aksionet e një banke, instrumentet që konvertohen në aksione ose të cilat japin të drejtën për të blerë aksione, si dhe instrumente, të cilat përfaqësojnë një interes mbi aksione ose instrumente të tjera të pronësisë.

26. "Krizë sistemike" është ndërprerja e veprimtarisë në sistemin financiar, e cila mund të këtë pasoja të rënda negative për tregun financiar dhe ekonominë reale.

27. "Kapitali rregullator" është shuma e kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

28. "Komisioni i Ndihmës Shtetërore" është organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore, i përcaktuar në ligjin "Për ndihmën shtetërore".

29. "Kompetencat e transferimit" janë kompetencat e specifikuara në shkronjat "ç" ose "d", të pikës 1, të nenit 47, të këtij ligji, për të transferuar aksionet, instrumentet e tjera të pronësisë, titujt e borxhit, aktivet, të drejtat apo detyrimet ose çdo kombinim të tyre nga një bankë në ndërhyrjen e jashtëzakonshme te një marrës.

30. "Kompetenca e zhvlerësimit dhe e konvertimit" janë kompetencat e përmendura në nenin 45 dhe në shkronjat "dh", "e", "ë", "h" dhe "i", të pikës 1, të nenit 47, të këtij ligji.

31. "Kreditor i prekur" është kreditori, pretendimi i të cilit lidhet me një detyrim që është zvogëluar ose kthyer në aksione ose instrumente të

tjera të pronësisë, nëpërmjet ushtrimit të kompetencës së zhvlerësimit ose konvertimit në zbatimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda.

32. "Klauzola e mospërmbushjes së ndërsjellë" është një klauzolë kontraktore, e cila zbatohet në rastet kur ndërmjet palëve ekzistojnë dy ose më shumë marrëdhënie kontraktore dhe mospërmbushja e detyrimeve që burojnë nga njëra kontratë konsiderohet si mospërmbushje e detyrimeve edhe e kontratës tjetër.

33. "Kontratat financiare" janë këto kontrata dhe marrëveshje:

a) kontratat e titujve, ku përfshihen:

i) kontratat për blerjen, shitjen ose dhënien hua të një titulli një grupi ose një indeksi titujsh;

ii) opsionet për një titull, një grup ose indeks titujsh;

iii) transaksionet e riblerjes ose transaksionet e ndërsjella të riblerjes për çdo titull, grup ose indeks të tillë;

b) kontratat e mallrave bazë, ku përfshihen:

i) kontratat për blerjen, shitjen ose dhënien hua të një malli bazë, një grupi mallrash bazë ose një indeksi mallrash bazë për lëvrim në të ardhmen;

ii) opsionet për një mall bazë, një grup ose indeks mallrash bazë;

iii) transaksionet e riblerjes ose transaksionet e ndërsjella të riblerjes për çdo mall bazë, grup apo indeks të tillë;

c) kontratat e ardhshme dhe të shtyra, përfshirë kontratat (me përjashtim të kontratës së mallit bazë) për blerjen, shitjen ose transferimin e një malli bazë ose prone me çfarëdo përshkrim tjetër, shërbimi, të drejte ose interesi, kundrejt një çmimi të përcaktuar në një datë të ardhshme;

ç) marrëveshjet e shkëmbimit, ku përfshihen:

i) marrëveshjet e këmbimit dhe opsionet e lidhura me norma interesi; marrëveshjet e këmbimit valutor të çastit ose marrëveshje të tjera të këmbimit valutor; marrëveshjet për monedhën; për një indeks kapitali neto ose kapital neto; një indeks borxhi ose borxh; indekse mallrash bazë ose mallra bazë;

ii) marrëveshje këmbimi të kredive, të marzhit mbi kreditë ose të kthimit total;

iii) çdo marrëveshje ose transaksion që është i ngjashëm me një marrëveshje të përmendur në nënndarjet "i" ose "ii", të kësaj shkronje, që është objekt i tregtimit të përsëritur në tregjet e kontratave të këmbimit ose të derivativëve;

d) marrëveshje e huamarrjes ndërbankare, ku afati i huamarrjes është tre muaj ose më pak se tre muaj;

dh) marrëveshjet kuadër për secilën prej kontratave ose marrëveshjeve të përmendura në shkronjat "a" deri në "d".

34. "Likuidim" është procesi i disponimit dhe kthimit në para të aktiveve të bankës, me qëllim shpërndarjen e tyre te kreditorët, sipas radhës së shlyerjes së detyrimeve.

35. "Marrësi" është subjekti, tek i cili transferohen aksionet, instrumentet e tjera të pronësisë, titujt e borxhit, aktivet, të drejtat ose detyrimet ose ndonjë kombinim i këtyre zërave nga një bankë në ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

36. "Marrëveshje e kolateralit financiar për transferimin e titullit" ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave.

37. "Marrëveshje kompensimi *netting*" është një marrëveshje, sipas së cilës një sërë të drejtash të kërkueshme ose detyrimesh mund të konvertohen në një detyrim të vetëm, përfshirë edhe dispozitat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave dhe dispozitat "*close-out*".

38. "Marrëveshje kompensimi *set-off*" është një marrëveshje, me anë të së cilës dy ose më shumë të drejta të kërkueshme ose detyrime borxhi ndërmjet një banke, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dhe një pale tjetër kompensojnë njëra - tjetrën.

39. "Mallra bazë" janë sende të përcaktuara në numër, në lloj dhe në sasi, të cilat mund të dorëzohen, përfshirë metalet, mineralet dhe aliazhet e tyre, produktet bujqësore dhe energjinë.

40. "Ndërhyrje e jashtëzakonshme" është procesi i zbatimit të kompetencave dhe të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim arritjen e njërit apo disa prej objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të parashikuara në nenin 20, të këtij ligji.

41. "Organe administrimi" janë këshilli drejtues dhe drejtoria, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

42."Obligacion i garantuar" është një instrument i emetuar nga një bankë me seli në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj dhe që plotëson kushtin që fondet e përfituara nga shitja e tij investohen në aktive, të cilat sigurojnë mbulim të mjaftueshëm për detyrimet që rrjedhin nga ky

obligacion deri në maturimin e tij dhe të cilat, në rast të mospërmbushjes së detyrimit nga emetuesi, përdoren duke i dhënë prioritet zotëruesit të obligacionit për rimbursimin dhe pagesat e principalit dhe të interesit.

43. "Procedurat e likuidimit të detyruar" janë procedurat e likuidimit të detyruar, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

44. "Skema e sigurimit të depozitave" ka të njëjtin kuptim siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

45. "Subjekt i grupit" është një person juridik që është pjesë e një grupi bankar.

46. "Titujt e borxhit" ka të njëjtin kuptim, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për titujt.

47. "Treg i rregulluar" ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për titujt.

48. "Veprimtari kryesore" janë veprimtaritë dhe shërbimet e lidhura, të cilat përfaqësojnë burimet me rëndësi materiale të të ardhurave, të fitimit ose të vlerës së emrit të mirë për një bankë ose për një grup, pjesë e të cilit është banka.

49. "Veprim i ndërhyrjes së jashtëzakonshme" është vendimi për zbatimin e një instrumenti ose ushtrimi i kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një bankë, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

50. "Zotërues i prekur" është zotëruesi i instrumenteve të pronësisë, të cilat janë anuluar ose zvogëluar me anë të kompetencës së referuar në shkronjën "h", të pikës 1, të nenit 47, të këtij ligji.

SEKSIONI 2
PARIMET DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE

Neni 5
Parime të përgjithshme

1. Banka e Shqipërisë, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë ushtrimit të kompetencave të saj ndaj subjekteve të këtij ligji, konsideron natyrën e aktivitetit, strukturën aksionare, formën ligjore, profilin e rrezikut, madhësinë dhe statusin ligjor, ndërlidhjen me institucione të tjera dhe me sistemin financiar në Shqipëri, qëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre.

2. Dispozitat ligjore, që rregullojnë funksionimin e bankave, zbatohen për bankat në ndërhyrje të jashtëzakonshme, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë ligj.

3. Dispozitat ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare, zbatohen për subjektet e këtij ligji që vendosen në ndërhyrje të jashtëzakonshme nga ana e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 6
Autoritetet përgjegjëse

1. Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i cili ushtron kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës, i cili ushtron funksionin mbikëqyrës në bazë dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për Bankën e Shqipërisë, legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe të këtij ligji.

3. Banka e Shqipërisë ushtron funksionin mbikëqyrës dhe funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme nëpërmjet dy njësive organizative të ndryshme brenda saj, të cilat kanë linja të veçanta raportimi dhe varësie, duke siguruar pavarësinë e tyre në vendimmarrjet përkatëse. Punonjësit e njësive organizative, të cilat përgjigjen për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe funksionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, bashkëpunojnë në mënyrë efektive për hartimin, planifikimin dhe zbatimin e vendimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Banka e Shqipërisë përcakton me akt nënligjor format dhe mënyrën e bashkëpunimit të këtyre njësive.

4. Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, informon Ministrinë e Financave dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore lidhur me vendimin e marrë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në një bankë. Në rastin kur vendimi për ndërhyrje të jashtëzakonshme shoqërohet me përdorimin e fondeve publike, veprohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

5. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për përgatitjen, planifikimin dhe zbatimin e vendimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

6. Banka e Shqipërisë përcakton organet e brendshme dhe drejtuesit e njësive organizative të saj, të cilat nxjerrin aktet administrative individuale në zbatim të kompetencave të Bankës së Shqipërisë, sipas këtij ligji.

KREU II
PËRGATITJA E PLANEVE TË RIMËKËMBJES DHE TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

SEKSIONI 1
PLANIFIKIMI I RIMËKËMBJES

Neni 7
Planet e rimëkëmbjes

1. Çdo bankë harton dhe përditëson planin e rimëkëmbjes, i cili parashikon masat që duhen marrë nga vetë banka për të rivendosur pozicionin financiar, në rast të një përkeqësimi të konsiderueshëm të gjendjes së saj financiare.

2. Planet e rimëkëmbjes përditësohen të paktën çdo vit ose pas çdo ndryshimi të strukturës organizative, të veprimtarisë ose të gjendjes financiare të bankës, që mund të ketë pasoja me rëndësi të konsiderueshme për zbatimin e planeve të rimëkëmbjes.

3. Plani i rimëkëmbjes përditësohet nga banka edhe me kërkesë të Autoritetit Mbikëqyrës.

4. Bankat, në hartimin e planeve të rimëkëmbjes, nuk duhet të marrin në konsideratë mundësinë e mbështetjes financiare publike të jashtëzakonshme.

5. Plani i rimëkëmbjes miratohet nga këshilli drejtues i bankës dhe i paraqitet për vlerësim Autoritetit Mbikëqyrës.

6. Autoriteti Mbikëqyrës, kur e gjykon të arsyeshme, për disa banka mund të lejojë paraqitjen e planeve të thjeshtuara të rimëkëmbjes.

7. Autoriteti Mbikëqyrës përcakton me akt nënligjor përmbajtjen e planeve të rimëkëmbjes dhe të planeve të thjeshtuara të rimëkëmbjes, mënyrën dhe afatin për paraqitjen e përditësimet e tyre.

Neni 8
Vlerësimi i planeve të rimëkëmbjes

1. Autoriteti Mbikëqyrës, brenda gjashtë muajve nga data e paraqitjes së planit të rimëkëmbjes nga banka, vlerëson nëse:

a) plani plotëson kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) zbatimi i masave të propozuara në plan krijon mundësinë që banka të ruajë ose të rivendosë pozicionin financiar;

c) plani dhe zgjidhjet alternative brenda planit kanë mundësi të zbatohen më shpejt dhe në mënyrë më të efektshme në situata vështirësie financiare, duke shmangur sa më shumë çdo pasojë të rëndë negative mbi sistemin financiar.

2. Autoriteti Mbikëqyrës, gjatë vlerësimit të planeve të rimëkëmbjes, merr në konsideratë përshtatshmërinë e kapitalit e të strukturës së fondeve të bankës, në raport me nivelin e kompleksitetit të strukturës organizative dhe profilin e rrezikut të bankës.

3. Autoriteti Mbikëqyrës, kur vlerëson se ka mangësi në planin e rimëkëmbjes ose pengesa të rëndësishme për zbatimin e tij, i kërkon bankës të paraqesë, brenda dy muajve, një plan të rishikuar ku pasqyrohet trajtimi i këtyre mangësive ose pengesave. Ky afat mund të zgjatet edhe një muaj me miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës.

Banka ka të drejtë t'i shprehë Autoritetit Mbikëqyrës opinionin e saj në lidhje me kërkesën për rishikimin e planit të rimëkëmbjes.

4. Në rast se edhe plani i rishikuar nuk trajton në mënyrën e duhur mangësitë dhe pengesat, autoriteti mbikëqyrës udhëzon bankën të bëjë ndryshime konkrete në plan.

5. Autoriteti Mbikëqyrës, në rastin kur banka nuk paraqet planin e rishikuar ose nëse plani i rishikuar nuk i korrigjon në mënyrën e duhur mangësitë apo pengesat e mundshme të identifikuara në vlerësimin e parë, edhe pas dhënies së udhëzimit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, i kërkon bankës të identifikojë brenda një afati të arsyeshëm ndryshimet që mund t'i bëjë veprimtarisë së saj për të trajtuar mangësitë ose pengesat për zbatimin e planit të rimëkëmbjes.

6. Autoriteti Mbikëqyrës, në rastin kur banka nuk i identifikon ndryshimet, sipas pikës 5, të këtij neni, brenda afatit të vendosur, ose nëse vlerësohet se veprimet e propozuara nga banka nuk i trajtojnë në mënyrën e duhur mangësitë ose pengesat, mund të urdhërojë bankën:

a) të ulë nivelin e rrezikut, përfshirë rrezikun e likuiditetit;

b) të mundësojë marrjen në kohë të masave për rikapitalizim;

c) të rishikojë strategjinë dhe strukturën e saj të veprimtarive kryesore;

ç) të bëjë ndryshime në strategjinë e financimit, në mënyrë që të përmirësojë aftësinë për rimëkëmbje të veprimtarive kryesore e të funksioneve me rëndësi kritike;

d) të bëjë ndryshime në strukturën e drejtimit të brendshëm të saj.

7. Urdhri i autoritetit mbikëqyrës, sipas pikës 6, të këtij neni, i njoftohet bankës me shkrim dhe i arsyetuar.

8. Çdo person fizik ose juridik, i cili pretendon se të drejtat apo interesat e ligjshëm të tij janë cenuar nga masat e mësipërme, ka të drejtë të kryejë ankim në përputhje me nenet 84 dhe 85 të këtij ligji.

9. Autoriteti Mbikëqyrës përcakton me akt nënligjor kriteret minimale, mbi bazën e të cilave kryhet vlerësimi i planeve të rimëkëmbjes.

Neni 9

Planet e rimëkëmbjes së grupit bankar

1. Banka mbizotëruese në një grup bankar harton planin e rimëkëmbjes së grupit bankar, i cili parashikon masat që duhen marrë në nivel grupi për të rivendosur pozicionin financiar, në rast të një përkeqësimi të konsiderueshëm të gjendjes financiare të grupit bankar.

2. Planet e rimëkëmbjes së grupit synojnë të arrijnë stabilizimin e grupit bankar në tërësi ose të një subjekti të grupit bankar, kur është në një situatë vështirësie financiare në mënyrë që të trajtohen ose të eliminohen shkaqet e problemit dhe të rivendoset pozicioni financiar i grupit bankar ose subjektit në fjalë, duke mbajtur njëkohësisht në konsideratë pozicionin financiar të subjekteve të tjera të grupit bankar.

3. Planet e rimëkëmbjes së grupit bankar dhe çdo plan i hartuar për një bankë të veçantë përfshijnë, sipas rastit, edhe masat rregulluese për mbështetjen financiare brenda grupit bankar, sipas një marrëveshjeje përkatëse.

4. Planet e rimëkëmbjes së grupit bankar identifikojnë nëse ekzistojnë apo jo pengesa ndaj zbatimit të masave të rimëkëmbjes brenda grupit bankar, përfshirë dhe ato për bankat individuale të përfshira në plan, dhe nëse ka pengesa kryesore praktike ose ligjore ndaj transferimit të menjëhershëm të fondeve ose shlyerjes së detyrimeve apo aktiveve brenda grupit bankar.

5. Autoriteti Mbikëqyrës, nëse e gjykon të nevojshme, mund të informojë mbi planet e rimëkëmbjes të grupit bankar edhe autoritete të tjera mbikëqyrëse vendase ose të huaja, me kusht që të zbatohen kërkesat e ruajtjes së konfidencialitetit dhe reciprocitetit të shkëmbimit e të administrimit të informacionit.

6. Planet e rimëkëmbjes së grupit bankar vlerësohen dhe miratohen nga këshilli drejtues i bankës mbizotëruese dhe i paraqiten për shqyrtim e vlerësim Autoritetit Mbikëqyrës.

Neni 10

Vlerësimi i planeve të rimëkëmbjes të grupit bankar

1. Autoriteti Mbikëqyrës i grupit bankar bashkëpunon me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të subjekteve të grupit dhe të degëve të rëndësishme, gjatë shqyrtimit të planeve të rimëkëmbjes së grupit bankar dhe vlerëson shkallën e plotësimit të kërkesave e të kritereve të parashikuara në nenet 8 e 9 të këtij ligji.

2. Vlerësimi i planeve të grupit bëhet në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 8, të këtij ligji, dhe merr në konsideratë efektin e mundshëm të masave të rimëkëmbjes në stabilitetin financiar të të gjitha vendeve ku ushtron veprimtarinë grupi.

3. Autoriteti Mbikëqyrës njofton bankën mbizotëruese të grupit bankar për rezultatet e vlerësimit të planit të rimëkëmbjes së grupit dhe mund të vërë në dijeni edhe autoritete të tjera mbikëqyrëse të subjekteve të grupit mbi këto rezultate.

Neni 11

Treguesit e planit të rimëkëmbjes

1. Në planet e rimëkëmbjes përfshihet një listë treguesish të vendosur nga bankat, të cilët identifikojnë momentet në të cilat mund të ndërmerren veprimet e përcaktuara në këto plane.

2. Autoriteti Mbikëqyrës, gjatë procesit të vlerësimit të planeve të rimëkëmbjes, miraton treguesit e përcaktuar në këto plane, të cilët mund të jenë tregues cilësorë ose sasiorë në lidhje me pozicionin financiar të bankës dhe që monitorohen me lehtësi.

3. Bankat sigurojnë monitorimin mbi baza të rregullta të treguesve të planeve të rimëkëmbjes, sipas akteve rregullative dhe procedurave të tyre të brendshme.

4. Bankat veprojnë në bazë të planeve të tyre të rimëkëmbjes edhe kur nuk është arritur treguesi përkatës, në rast se këshilli drejtues i bankës e konsideron këtë si vendimin e duhur në bazë të rrethanave ose mund të mos veprojnë sipas planit të rimëkëmbjes edhe kur janë arritur treguesit, në rast se këshilli drejtues gjykon se në situatën aktuale ky veprim nuk do të ishte i përshtatshëm.

5. Bankat njoftojnë me shkrim autoritetin mbikëqyrës mbi vendimin për të ndërmarrë ose për të mos e ndërmarrë një veprim të përcaktuar në planet e rimëkëmbjes.

6. Autoriteti Mbikëqyrës përcakton me akt nënligjor kuadrin minimal të treguesve cilësorë dhe sasiorë, të cilët duhet të përfshihen në planet e rimëkëmbjes së bankave.

SEKSIONI 2
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 12
Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme harton planin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme për çdo bankë.

2. Në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikohen veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që ndërmerr Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në rastet kur plotësohen kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

3. Në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme identifikohet çdo pengesë e rëndësishme për mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përshkruhen veprimet përkatëse për heqjen e pengesave, sipas nenit 15 të këtij ligji.

4. Planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme rishikohen të paktën një herë në vit ose pas çdo ndryshimi të strukturës organizative, veprimtarisë ose të gjendjes financiare të bankës, si dhe në rast të ndryshimeve të tjera, që ndikojnë në përmbajtjen dhe zbatueshmërinë e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

5. Banka i siguron Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme të kërkuara për procesin e hartimit e të përditësimit të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përcaktohen rastet kur përdoren instrumentet dhe kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ky plan përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

a) përmbledhje të ndryshimeve të rëndësishme në bankë, të cilat kanë ndodhur pas dhënies së informacioneve më të fundit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme;

b) mënyrën se si mund të veçohen juridikisht dhe ekonomikisht funksionet me rëndësi kritike dhe veprimtaritë kryesore nga funksionet e tjera, me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e tyre;

c) një vlerësim të afateve për ekzekutimin e çdo veprimi me rëndësi të planit;

ç)vlerësimin e aftësisë për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe masave për heqjen e pengesave, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;

d) një përshkrim të proceseve për përcaktimin e vlerës dhe të mundësive të shitjes së funksioneve me rëndësi kritike, veprimtarive kryesore dhe aktiveve të bankës;

dh) mënyrën e mundshme të financimit të instrumenteve dhe kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që mund të zbatohen, por pa marrë në konsideratë:

i) mbështetje financiare publike të jashtëzakonshme, përveç përdorimit të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

ii) mbështetje të jashtëzakonshme me likuiditet nga Banka e Shqipërisë; ose

iii) mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, të ofruar me kushte jostandarde sa i takon kolateralizimit, afatit të shlyerjes apo normës së interesit;

e) një përshkrim të hollësishëm të strategjive të ndryshme për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, të cilat mund të zbatohen sipas skenarëve të mundshëm dhe sipas afateve të zbatueshme;

ë) një përshkrim të mundësive për vazhdimësinë e funksionimit të shërbimeve të pagesave dhe kleringut dhe një vlerësim të ruajtjes së pozicioneve të klientëve;

f) një analizë të efektit që ka plani te punëmarrësit e bankës dhe një përshkrim të procedurave të parashikuara për t'u konsultuar me ta gjatë procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

g) një plan për komunikimin me mediat dhe publikun;

gj) kërkesën minimale për kapital rregullator dhe detyrime të pranuara në bazë të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, si dhe afatin brenda të cilit duhet arritur

ky nivel;

h) një përshkrim të operacioneve dhe sistemeve kryesore për vazhdimësinë e funksioneve të bankës;

i) opinione dhe komente të bankës në lidhje me planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

6. Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme merr në konsideratë skenarët përkatës, përfshirë faktin se ngjarja mund të ndodhë për arsye që lidhen me bankën konkrete ose mund të ndodhë për arsye që lidhen me një mungesë stabiliteti financiar apo ngjarje që prekin të gjithë sistemin. Ky plan nuk merr në konsideratë në asnjë rast sa më poshtë:

a) mbështetje financiare publike të jashtëzakonshme, përveç përdorimit të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

b) mbështetje të jashtëzakonshme me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, siç përcaktohet në ligjin organik të Bankës së Shqipërisë; ose

c) mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, të ofruar me kushte jostandarde për sa i takon kolateralizimit, afatit të shlyerjes apo normës së interesit.

7. Në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshihet edhe një analizë e mënyrës dhe momentit kur banka mund të paraqesë kërkesën për të përdorur instrumente financiare të Bankës së Shqipërisë dhe identifikohen ato aktive që plotësojnë kushtet për t'u pranuar si kolateral.

8. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr opinionin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në rastet kur kërkohet përfshirja e agjencisë, si dhe i paraqet një kopje të këtyre planeve e të çdo ndryshimi.

9. Përmbajtja e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme përcaktohet me akt nënligjor nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Neni 13

Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme të grupit bankar

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme harton planin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në çdo grup bankar.

2. Në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të grupit bankar:

a) parashtrohen masat që merren në lidhje me subjektet e grupit bankar;

b) shqyrtohet shkalla, me të cilën instrumentet dhe kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përdoren dhe ushtrohen në mënyrë të bashkërenduar për subjektet e grupit bankar, përfshirë masat për të ndihmuar në blerjen nga një palë e tretë e grupit bankar si të tërë ose e veprimtarive të veçanta, që realizohen nga subjektet e grupit bankar ose e subjekteve të veçanta të tij dhe identifikohet çdo pengesë e mundshme për ndërhyrjen e jashtëzakonshme;

c) identifikohen masat e nevojshme për të ndihmuar në ndërhyrjen e jashtëzakonshme duke konsideruar mundësinë e ndarjes juridike e ekonomike të funksioneve ose të veprimtarive të veçanta;

ç) parashtrohen veprime të tjera shtesë, që mund të ndërmerren në nivel grupi bankar;

d) merren në konsideratë skenarët përkatës, përfshirë faktin se ngjarja mund të ndodhë për arsye që lidhen me grupin bankar konkret ose mund të ndodhë për arsye që lidhen me një mungesë stabiliteti financiar apo ngjarje që prekin të gjithë sistemin, si dhe identifikohen mënyrat e financimit të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të grupit bankar, duke mos konsideruar sa më poshtë:

i) mbështetje financiare publike të jashtëzakonshme, përveç përdorimit të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

ii) mbështetje të jashtëzakonshme me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, siç përcaktohet në ligjin organik të Bankës së Shqipërisë; ose

iii) mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, të ofruar me kushte jostandarde sa i takon kolateralizimit, afatit të shlyerjes apo normës së interesit.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr opinionin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në rastet kur kërkohet përfshirja e Agjencisë, si dhe i paraqet një kopje të këtyre planeve dhe të çdo ndryshimi.

Neni 14

Kërkesa dhe procedura për planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të grupit bankar

Banka mbizotëruese në një grup bankar i paraqet Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme informacionin që mund të kërkohet prej tij në nivel grupi, në përputhje me

pikën 5, të nenit 12, të këtij ligji, për të përgatitur planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në nivel grupi.

Neni 15

Vlerësimi i planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe heqja e pengesave

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse banka duhet të likuidohet sipas procedurës së likuidimit të detyruar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat, ose t'i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim që të shmangë sa më shumë çdo pasojë të rëndë negative për sistemin financiar.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme bën vlerësimin sipas pikës 1, të këtij neni, duke mos marrë në konsideratë në asnjë rast sa më poshtë:

a) mbështetje financiare publike të jashtëzakonshme, përveç përdorimit të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

b) mbështetje të jashtëzakonshme me likuiditet nga Banka e Shqipërisë; ose

c) mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, të ofruar me kushte jostandarde për sa i takon kolateralizimit, afatit të shlyerjes apo normës së interesit.

3. Vlerësimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe është pjesë e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuar në nenin 12 të këtij ligji.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave të dhëna mbi depozitat e siguruara të kompensueshme të bankës, si dhe kostot e parashikuara në lidhje me procesin e kompensimit të këtyre depozitave.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në raste kur vëren se ka pengesa thelbësore për kryerjen e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një bankë, urdhëron bankën të paraqesë brenda katër muajve një propozim me masa të mundshme për trajtimin ose heqjen e këtyre pengesave.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, kur vlerëson se masat e propozuara nga banka në përputhje me pikën 5, të këtij neni, nuk zvogëlojnë në mënyrë efektive ose nuk heqin pengesat për realizimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, urdhëron bankën që brenda një afati kohor të caktuar të marrë një nga masat e mëposhtme, shoqëruar me arsyetimin përkatës:

a) të rishikojë marrëveshjet për mbështetje financiare brenda grupit ose të marrë në konsideratë lidhjen e një marrëveshjeje të tillë në qoftë se ajo nuk është përfunduar akoma dhe/ose të hyjë në një marrëveshje shërbimi brenda grupit ose me palë të treta për të siguruar vazhdimin e kryerjes së funksioneve me rëndësi kritike;

b) të kufizojë ekspozimet e veta maksimale individuale dhe të agreguara;

c) të raportojë rregullisht ose sipas rastit informacione shtesë të kërkuara prej tij;

ç) të shesë aktive të caktuara;

d) të kufizojë ose të ndërpresë veprimtari të veçanta ekzistuese ose shitjen e produkteve të veçanta bankare;

dh) të kryejë dhe/ose të mundësojë ndryshimet e duhura organizative të bankës dhe/ose të çdo subjekti tjetër të grupit bankar, i cili është nën kontrollin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të bankës, në mënyrë që të reduktojë kompleksitetin e bankës dhe/ose të grupit dhe të sigurojë që funksionet me rëndësi kritike mund të ndahen nga funksionet e tjera në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

e) të emetojë detyrime të pranuara për të përmbushur kërkesat, sipas nenit 32 të këtij ligji;

ë) të marrë masa të tjera për të përmbushur kërkesat minimale për kapitalin rregullator dhe detyrimet e pranuara, sipas parashikimeve të nenit 32 të këtij ligji.

7. Urdhri i nxjerrë sipas parashikimeve të pikës 6, të këtij neni, përcakton masat në përputhje me natyrën e aktivitetit, strukturën aksionare, formën ligjore, profilin e rrezikut, madhësinë dhe statusin ligjor, si dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës.

8. Banka, brenda një muaji nga data e marrjes së urdhrit të përmendur në pikën 6, të këtij neni, i paraqet Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme një plan për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë urdhër.

9. Vlerësimi i mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe heqja e pengesave sipas këtij neni zbatohet edhe në rastin e vlerësimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në një grup bankar.

10. Çdo person fizik ose juridik, i cili pretendon se të drejtat apo interesat e ligjshëm të tij janë cenuar nga masat e përcaktuara në pikën 6, të këtij neni, ka të drejtë të kryejë ankim në përputhje me nenet 84 dhe 85 të këtij ligji.

KREU III
MBËSHTETJA FINANCIARE BRENDA GRUPIT

Neni 16
Marrëveshja për mbështetje financiare brenda grupit

1. Banka mbizotëruese ose një subjekt tjetër i një grupi bankar, i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes së konsoliduar, mund të hyjë në një marrëveshje me subjektet e tjera të grupit për të siguruar mbështetje financiare për çdo palë të marrëveshjes që plotëson kushtet për ndërhyrjen e hershme, sipas kreut IV, të këtij ligji, me miratimin paraprak të autoritetit mbikëqyrës.

2. Marrëveshja për mbështetje financiare brenda grupit mund të lidhet vetëm nëse në momentin e nënshkrimit, sipas vlerësimit të autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse, asnjë prej palëve nuk i përmbush kushtet për ndërhyrje të hershme.

3. Mbështetja financiare, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të jepet në formën e një kredie, garancie ose si kombinim i tyre për një apo disa transaksione ndërmjet përfituesve të kësaj mbështetjeje dhe një pale të tretë.

4. Marrëveshja për mbështetje financiare brenda grupit specifikon në mënyrë të veçantë parimet për llogaritjen e shumave që do të paguhen për çdo transaksion të parashikuar, sipas marrëveshjes, si dhe shumën maksimale të ofrimit të mbështetjes financiare.

5. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja për mbështetje financiare brenda grupit nuk mund t'u transferohen palëve të treta jashtë grupit bankar.

6. Autoriteti mbikëqyrës përcakton me akt nënligjor kushtet për dhënien e miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar.

KREU IV
NDËRHYRJA E HERSHME

Neni 17
Masat e ndërhyrjes së hershme

1. Autoriteti Mbikëqyrës, kur vlerëson se niveli i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës afrohet në nivelin minimal të lejuar ose ekziston mundësia për shkeljen e shpejtë të kërkesave ligjore e rregullative, për shkak, ndër të tjera, të përkeqësimit me shpejtësi të gjendjes së saj financiare, duke përfshirë përkeqësimin e treguesve të likuiditetit, rritjen e kredive me probleme ose rritjen e përqendrimit të ekspozimeve, ka të drejtë që, krahas masave mbikëqyrëse, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, të marrë një ose disa nga masat e ndërhyrjes së hershme, si më poshtë:

a) të kërkojë nga këshilli drejtues i bankës të analizojë situatën dhe të identifikojë masat për kapërcimin e problemeve të identifikuara, si dhe të hartojë një program veprimi për kapërcimin e tyre;

b) të kërkojë nga këshilli drejtues i bankës të zbatojë një ose disa masa të përcaktuara në planin e rimëkëmbjes dhe nëse rrethanat, të cilat shkaktuan ndërhyrjen e hershme, janë të ndryshme nga supozimet e parashikuara në planin e rimëkëmbjes, t'i kërkojë përditësimin e planit të rimëkëmbjes dhe të zbatojë një ose më shumë prej masave të përcaktuara në planin e rimëkëmbjes të përditësuar brenda një afati kohor të caktuar;

c) të kërkojë nga këshilli drejtues i bankës të thërrasë një mbledhje të asamblesë së aksionarëve ose të thërrasë vetë një mbledhje të asamblesë së aksionarëve, në qoftë se këshilli drejtues i bankës nuk e bën këtë dhe në të dyja rastet të caktojë datën e mbledhjes, rendin e ditës dhe të propozojë për miratim vendimet përkatëse;

ç)të kërkojë nga këshilli drejtues i bankës të hartojë një plan për negocimin e ristrukturimit të borxhit me kreditorët e bankës në përputhje me planin e rimëkëmbjes, kur kjo është e aplikueshme;

d) të kërkojë ndryshime në strategjinë e biznesit apo strukturën juridike ose operacionale të bankës;

dh) të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm për përditësimin e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përgatitjen për mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe për vlerësimin e aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të bankës, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

2. Çdo person fizik ose juridik, i cili pretendon se të drejtat apo interesat e ligjshëm të tij janë cenuar nga masat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, ka të drejtë të kryejë ankim në përputhje me nenet 84 dhe 85 të këtij ligji.

3. Autoriteti Mbikëqyrës përcakton me akt nënligjor kushtet kur zbatohen masat e ndërhyrjes së hershme.

Neni 18
Zëvendësimi i administratorëve

1. Kur Autoriteti Mbikëqyrës konstaton se ka një përkeqësim të konsiderueshëm të gjendjes financiare të bankës ose ka shkelje me pasoja të rënda të legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe rregullave të tjera ose statutit të bankës dhe në rast se banka nuk zbaton masat e përcaktuara në nenin 17, të këtij ligji, ose këto masa nuk janë të mjaftueshme për të korrigjuar gjendjen financiare të bankës, ka të drejtë të urdhërojë bankën të shkarkojë nga detyra një ose disa prej administratorëve të bankës, anëtarë të këshillit drejtues dhe/ose të drejtorisë, dhe të emërojë administratorë të rinj.

2. Administratorët e rinj emërohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe kërkesat e përcaktuara për emërimin e tyre.

3. Banka ose administratorët e cenuar kanë të drejtë të ankimojnë urdhrin e Autoritetit Mbikëqyrës, në përputhje me nenet 84 dhe 85 të këtij ligji.

Neni 19
Administrimi i përkohshëm

1. Autoriteti Mbikëqyrës ka të drejtë të emërojë një ose më shumë administratorë të përkohshëm për bankën, në rast se banka nuk zbaton urdhrin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 18, të këtij ligji, ose kur konsideron se zëvendësimi i administratorëve, i përmendur në nenin 18, të këtij ligji, është i pamjaftueshëm në funksion të përmirësimit të situatës financiare të bankës.

2. Autoriteti Mbikëqyrës, si rregull, mund t'i emërojë këta administratorë të përkohshëm për të bashkëpunuar përkohësisht me këshillin drejtues, por edhe për të zëvendësuar përkohësisht këshillin drejtues të bankës.

3. Në vendimin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen objektivat dhe detyrat e administratorit të përkohshëm, të cilat synojnë konstatimin e gjendjes së vërtetë financiare të bankës, administrimin e të gjithë ose të një pjese të veprimtarisë, me qëllim ruajtjen ose rivendosjen e pozitës financiare të bankës dhe/ose funksionimin e sigurt dhe të shëndoshë.

4. Nëse Autoriteti Mbikëqyrës e emëron administratorin e përkohshëm për të bashkëpunuar me këshillin drejtues të bankës, ai përcakton në momentin e emërimit edhe rolin, detyrat dhe kompetencat e administratorit të përkohshëm dhe çdo kërkesë që duhet të përmbushë këshilli drejtues i bankës me administratorin e përkohshëm, në formën e konsultimit ose marrjes së pëlqimit të tij, përpara marrjes së vendimeve apo masave konkrete. Autoriteti Mbikëqyrës bën publik emërimin e çdo administratori të përkohshëm që ka të drejtën e përfaqësimit të bankës me palët e treta.

5. Administratori i përkohshëm emërohet për një afat jo më të gjatë se një vit. Ky afat mund të zgjatet vetëm nëse autoriteti mbikëqyrës vlerëson se kushtet për emërimin e administratorit të përkohshëm, të përcaktuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, vazhdojnë të ekzistojnë. Autoriteti Mbikëqyrës mundet që në çdo kohë gjatë mandatit të administratorit të përkohshëm të nxjerrë një vendim për ta shkarkuar atë, si dhe mund të ndryshojë kompetencat e detyrat e përcaktuara në vendimin e emërimit.

6. Administratori i përkohshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të përmbushë kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për administratorët e bankës ose degës së bankës së huaj;

b) të ketë përvojë pune, të paktën 7-vjeçare, si drejtues ekzekutiv në një bankë, institucion tjetër financiar ose në një shoqëri të ekspertëve kontabël të autorizuar;

c) të mos jetë dënuar nga gjykata për një vepër penale;

ç) të mos jetë subjekt i hetimeve për vepra penale;

d) të mos jetë në pamundësi për të ushtruar detyrat ndaj bankës, bazuar në një vendim gjykate;

dh) të mos ketë konflikt interesi me bankën, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

7. Autoriteti Mbikëqyrës në vendimin sipas pikës 1, të këtij neni, mund të përcaktojë që veprime ose masa të veçanta që merr administratori i përkohshëm ose i rekomandon për këshillin drejtues të miratohen paraprakisht prej Autoritetit Mbikëqyrës.

8. Administratori i përkohshëm i paraqet Autoritetit Mbikëqyrës raporte për gjendjen financiare të bankës dhe veprimet e ndërmarra për kryerjen e detyrave të tij, në intervale kohore të përcaktuara nga Autoriteti Mbikëqyrës dhe në fund të mandatit të tij.

9. Autoriteti Mbikëqyrës, bazuar në raportet e paraqitura nga administratori i përkohshëm, sipas pikës 8, të këtij neni, kur e çmon të nevojshme, urdhëron këtë të fundit të thërrasë asamblenë e aksionarëve të bankës dhe t'i kërkojë asaj rritjen e kapitalit.

10. Administratori i përkohshëm detyrohet të thërrasë mbledhjen e asamblesë së aksionarëve të bankës jo më vonë se 10 ditë pas marrjes së urdhrit të Autoritetit Mbikëqyrës.

11. Administratori i përkohshëm, në rastet kur refuzohet rritja e kapitalit ose nëse brenda 6 muajve nuk realizohet rritja e tij, vë në dijeni Autoritetin Mbikëqyrës, i cili merr vendimet përkatëse në zbatim të këtij ligji dhe/ose të legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

12. Vendimi i Autoritetit Mbikëqyrës për administrimin e përkohshëm, emërimi dhe largimi i administratorit të përkohshëm dhe ndërprerja e administrimit të përkohshëm në një bankë i njoftohen me shkrim Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

13. Autoriteti Mbikëqyrës mund të përcaktojë me akt nënligjor kushtet dhe mënyrën e kryerjes së administrimit të përkohshëm.

14. Emërimi i administratorit të përkohshëm, sipas përcaktimeve të këtij neni, nuk cenon të drejtat e aksionarëve të bankës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, për aq sa nuk bien në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji.

15. Banka ose administratorët e cenuar kanë të drejtë të ankimojnë emërimin e administratorit ose administratorëve të përkohshëm, në përputhje me nenet 84 dhe 85 të këtij ligji.

KREU V
NDËRHYRJA E JASHTËZAKONSHME
SEKSIONI 1
OBJEKTIVAT, KUSHTET DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 20
Objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton instrumentin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me kushtet konkrete të bankës apo të sistemit financiar në tërësi, për arritjen sa më të mirë të objektivave.

2. Objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë:

a) të sigurojë vazhdimësinë e funksioneve kritike të bankës;

b) të shmangë çdo pasojë të rëndë negative për stabilitetin e sistemit financiar, duke parandaluar përhapjen e rreziqeve, përfshirë edhe infrastrukturat e tregut, dhe duke ruajtur disiplinën e tregut;

c) të mbrojë fondet publike, duke minimizuar mbështetjen financiare publike të jashtëzakonshme;

ç) të mbrojë depozituesit e siguruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave;

d) të mbrojë fondet dhe aktivet e tjera të klientëve.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në përmbushjen e objektivave, sipas pikës 2, të këtij neni, synon të zvogëlojë koston e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe rënien e vlerës së bankës.

4. Objektivat e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, kanë rëndësi të njëjtë dhe Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme i vlerëson këta objektiva në mënyrë të përshtatshme, sipas rrethanave për çdo rast individual.

Neni 21
Kushtet për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme, kur konstaton se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) banka konsiderohet të jetë pranë një situate të paaftësisë paguese;

b) nuk ekziston mundësia që një masë tjetër e marrë nga banka, grupi bankar ose aksionarët e bankës apo një masë mbikëqyrëse ose masë e ndërhyrjes së hershme, e marrë nga Autoriteti

Mbikëqyrës në mbështetje të legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë apo sipas këtij ligji, të rivendosë bankën brenda një periudhe të arsyeshme, në kushte të mira financiare dhe brenda treguesve mbikëqyrës;

c) ndërhyrja e jashtëzakonshme ndaj bankës është e nevojshme për interesin publik, sipas përcaktimit të pikës 5 të këtij neni.

2. Për qëllimet e shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, banka konsiderohet të jetë pranë një situate të paaftësisë paguese në qoftë se plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) kur banka nuk plotëson ose kur ekzistojnë kushte objektive, të cilat krijojnë bindjen se banka në të ardhmen e afërt mund të mos plotësojë kërkesat për të vazhduar të jetë e licencuar dhe të plotësojë kushtet për heqjen e licencës nga Autoriteti Mbikëqyrës, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në faktin se banka ka pësuar ose ekziston mundësia që të pësojë humbje, të cilat përthithin të gjithë ose një sasi të konsiderueshme të kapitalit të saj;

b) aktivet e bankës janë më të vogla sesa detyrimet e saj ose ekziston mundësia që të jenë të tilla në të ardhmen e afërt;

c) banka nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet financiare ose ekziston mundësia që në të ardhmen e afërt të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet kur ato bëhen të kërkueshme;

ç)është e nevojshme të sigurohet mbështetje financiare publike e jashtëzakonshme, e përcaktuar në nenin 43 të këtij ligji.

3. Nëse mbështetja financiare publike i jepet në formën e një ndihme të përkohshme një banke në gjendje të shëndetshme financiare, për të ruajtur stabilitetin e sistemit financiar, ajo mbështetje nuk do të konsiderohet si kusht për qëllime të pikës 2, shkronja "ç", të këtij neni. Kjo mbështetje financiare publike jepet në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në çdo rast, mbështetja financiare publike nuk duhet të përdoret për përthithjen e humbjeve dhe në kushte që i japin bankës një përparësi në treg dhe cenojnë konkurrencën, si dhe në rast se nuk ekziston asnjë nga kushtet e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij neni, dhe pikës 3, të nenit 45, të këtij ligji.

4. Ndërhyrja e jashtëzakonshme konsiderohet se është në interes publik, në kuptim të shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni, në qoftë se çmohet e nevojshme për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për arritjen e një ose më shumë objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të parashikuar në nenin 20, të këtij ligji, të cilat nuk do të mund të arriheshin nëpërmjet procedurave të likuidimit të detyruar.

5. Fillimi i procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk kushtëzohet nga marrja e masave të ndërhyrjes së hershme.

Neni 22

Parimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Ndërhyrja e jashtëzakonshme bazohet në parimet e mëposhtme:

a) aksionarët e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme janë të parët që përballojnë humbjet;

b) kreditorët e bankës mbartin humbjet pas aksionarëve, sipas radhës së shlyerjes së detyrimeve në procedurën e likuidimit të detyruar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj;

c) kreditorët e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme nuk duhet të pësojnë humbje më të mëdha se humbjet që ata mund të pësonin nëse banka do të ishte vendosur në procedurën e likuidimit të detyruar;

ç) depozitat e siguruara janë plotësisht të mbrojtura deri në nivelin maksimal të mbulimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave;

d) administratorët e bankës shkarkohen, me përjashtim të rasteve kur vazhdimi i detyrës nga ana e tyre konsiderohet se është i nevojshëm për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

dh) administratorët e bankës në detyrë janë të detyruar të sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

e) administratorët e bankës, të cilët kanë ndikuar në vendosjen e saj në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e shkaktuara me dashje ose nga pakujdesia, që i kanë shkaktuar dëme bankës;

ë)masat mbrojtëse për aksionarët dhe kreditorët e bankës dhe për palët e treta zbatohen në përputhje me këtë ligj;

f) kreditorët e klasave të njëjta trajtohen në mënyrë të barabartë, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kujdeset që të minimizohen efektet negative të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për subjektet e tjera të grupit bankar dhe për stabilitetin e sistemit financiar në tërësi.

3. Në rastet kur në një bankë aplikohet instrumenti i shitjes së aktivitetit tregtar, instrumenti i bankës urë apo instrumenti i ndarjes së aktiveve, punëmarrësit e bankës trajtohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Neni 23
Administrimi i posaçëm

1. Nëse Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson se një ndryshim në organet e administrimit të bankës mund të kontribuojë në arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ai ka të drejtë të vendosë bankën në administrim të posaçëm, duke emëruar një ose më shumë administratorë të posaçëm.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr vendimin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, në çdo kohë që e gjykon të arsyeshme gjatë procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Me hyrjen në fuqi të vendimit, sipas pikës 1, të këtij neni, funksionet dhe kompetencat e organeve të administrimit, si dhe kompetencat e asamblesë së aksionarëve ushtrohen nga administratori i posaçëm.

4. Administratori i posaçëm emërohet për një afat jo më të gjatë se një vit. Ky afat mund të zgjatet në rastet kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson se vazhdojnë të ekzistojnë kushtet për të cilat u emërua administratori i posaçëm, sipas këtij neni.

5. Vendimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, përcakton nivelin e shpërblimit të administratorit të posaçëm, i cili përballohet nga banka.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund ta zëvendësojë në çdo kohë administratorin e posaçëm.

7. Administratori i posaçëm duhet të jetë një person i pavarur nga banka dhe duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pikën 6, të nenit 19, të këtij ligji.

8. Administratori i posaçëm merr masat e nevojshme për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe zbaton instrumentet e kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me këtë ligj.

9. Administratori i posaçëm ushtron të drejtat dhe detyrat e mëposhtme:

a) dërgon në çdo zyrë dhe njësi të bankës një njoftim për datën dhe kohën kur hyn në fuqi administrimi i posaçëm i bankës dhe emërimin e tij, si dhe urdhrin e nxjerrë nga ai lidhur me hierarkinë e marrjes së vendimeve e kryerjen e veprimeve;

b) kërkon nga administratorët e tjerë dhe punonjësit e bankës t'i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e bankës, të përgatitin raporte për gjendjen e saj, si dhe të japin me kërkesën e tij informacione me shkrim e raporte shtesë për veprimtarinë e bankës;

c) ka të drejtë të shkarkojë çdo punonjës që refuzon të japë informacionin e kërkuar prej tij;

ç) brenda 30 ditëve nga data e emërimit të tij, merr në dorëzim të gjithë inventarin e aktiveve dhe të pasurive të bankës, si dhe të gjithë dokumentacionin e arkivit;

d) merr të gjitha masat për ruajtjen e aktiveve të bankës, duke ndërmarrë të paktën veprimet e mëposhtme:

i) ndryshon rregullin e hyrjes në ndërtesat dhe në mjediset ku ruhen pasuritë, dokumentacioni, informacioni, pajisjet, përdorimi i të cilave dëmton interesat pasurorë të bankës, duke zëvendësuar kodet dhe fjalëkalimet e duke vendosur kufizime të rrethit të personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto mjedise;

ii) ndryshon ose krijon fjalëkalime të reja për hyrjet në rrjetin kompjuterik, si dhe lëshon lloje të reja të kartave të kalimit për hyrjet në mjediset e bankës për punonjësit e autorizuar dhe kontrollon hyrjet e punonjësve të tjerë në këto mjedise;

iii) pezullon ushtrimin e kompetencave të personave, të cilët mund të ushtrojnë veprimtari në emër e për llogari të bankës dhe autorizon punonjësit e caktuar prej tij;

iv) njofton palët e treta për të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë me autorizimet dhe të drejtën e përfaqësimit;

v) informon bankat korrespondente, agjentët e letrave me vlerë dhe personat që administrojnë aktivet e regjistrat në emër të bankës se të gjitha autorizimet e dhëna nga banka deri në emërimin e

tij janë pezulluar dhe autorizimet i jepen një numri të kufizuar personash, emrat e të cilëve u informohen;

vi) ndalon pagesën e dividendëve ose shpërndarjen e kapitalit për aksionarët si dhe pagesën e administratorëve, përveç shpërblimit për shërbimet që ata kanë kryer në bankë;

vii) me miratimin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, mund të vendosë që banka për një periudhë të caktuar kohe të mos mbledhë depozita dhe të mos paguajë detyrimet që ka ndaj palëve të treta.

10. Gjatë periudhës në të cilën banka është vendosur në administrim të posaçëm, të gjitha transaksionet e kryera prej saj, pa autorizimin përkatës të administratorit të posaçëm ose të personave të përcaktuar prej tij, nuk kanë vlefshmëri ligjore.

11. Administratori i posaçëm ka të drejtë të urdhërojë nëpunësit dhe administratorët për zbatimin e funksioneve të veçanta në bankë. Këta administratorë dhe nëpunës mund të shkarkohen nga administratori i posaçëm në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës dhe legjislacionin përkatës.

12. Administratori i posaçëm i paraqet Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme një raport për veprimtarinë dhe gjendjen financiare të bankës, në fillim dhe në fund të mandatit të tij, si dhe veprimet e ndërmarra në përmbushje të detyrave të tij, në intervale mujore apo më shpesh nëse e kërkon Autoriteti.

13. Administratori i posaçëm ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e tij nën kontrollin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

14. Vendimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, mund të përcaktojë kufizime të funksioneve dhe të të drejtave të administratorit të posaçëm ose që veprime të caktuara ligjore të administratorit të posaçëm t'i nënshtrohen miratimit paraprak të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

15. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme publikon emërimin e administratorit të posaçëm në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

16. Vendimi për administrim të posaçëm, emërimi dhe shkarkimi i administratorit të posaçëm, si dhe ndërprerja e administrimit të posaçëm në një bankë regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga ana e administratorit të posaçëm, mbështetur në vendimin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

17. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme njofton menjëherë Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për marrjen e vendimit dhe bashkëpunon me të gjatë administrimit të posaçëm.

Neni 24

Vlerësimi për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, përpara se të fillojë procedura e ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose përpara ushtrimit të kompetencës për zhvlerësimin dhe konvertimin, siguron që të kryhet një vlerësim i drejtë, i kujdesshëm dhe realist i aktiveve dhe detyrimeve të bankës nga një vlerësues i pavarur nga banka, nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe nga çdo autoritet publik.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të kryejë një vlerësim të përkohshëm të aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të bankës, nëse nuk është i mundur vlerësimi i pavarur, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Objektivi i vlerësimit është përcaktimi i vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të bankës në momentin që përmbush kushtet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas nenit 21 të këtij ligji.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr të dhëna nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në lidhje me:

a) listën e depozituesve dhe shumat e depozitave që kompensohen në rast të likuidimit të detyruar të bankës;

b) të gjitha shpenzimet e parashikuara të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave që lidhen me procesin e kompensimit;

c) të dhëna për gjendjen e "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" dhe "Fondit të kompensimit të depozitave" në banka.

5. Qëllimi i vlerësimit është të sigurojë informacionin e nevojshëm për Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në lidhje me:

a) plotësimin e kushteve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme;

b) zgjedhjen e instrumentit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përshtatshëm për t'u zbatuar në bankë, si dhe kushtet për ushtrimin e kompetencës së zhvlerësimit e të konvertimit;

c) përcaktimin e shkallës së anulimit ose zvogëlimit të numrit të aksioneve, si dhe masën e zhvlerësimit ose konvertimit të detyrimeve në instrumente përkatëse të kapitalit, kur zbatohen kompetencat e zhvlerësimit ose konvertimit të tyre;

ç)përcaktimin e shkallës së zhvlerësimit ose konvertimit në instrumente përkatëse të kapitalit të detyrimeve, kur zbatohet instrumenti i rikapitalizimit nga brenda;

d) aktivet, të drejtat, detyrimet ose aksionet apo instrumentet e tjera të pronësisë që duhen transferuar, si dhe për vlerën e shpërblimit që i duhet paguar bankës, e cila është objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ose zotëruesve të aksioneve kur zbatohet instrumenti i bankës urë ose i ndarjes së aktiveve;

dh) aktivet, të drejtat, detyrimet ose aksionet që duhen transferuar kur përdoret instrumenti i shitjes së aktivitetit tregtar;

e) çdo humbje mbi aktivet e bankës, e cila mund të njihet plotësisht në momentin e përdorimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose të ushtrimit të kompetencës së zhvlerësimit ose konvertimit.

6. Vlerësimi plotësohet me informacionet e mëposhtme, siç paraqitet në librat kontabël dhe regjistrat e bankës:

a) bilancin e përditësuar dhe një raport për gjendjen financiare të bankës;

b) një analizë të vlerës kontabël të aktiveve;

c) listën e detyrimeve të mbajtura brenda dhe jashtë bilancit, të paraqitura në librat kontabël dhe regjistrat e bankës, duke treguar nivelet e përparësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, në rastin e fillimit të procedurave të likuidimit të detyruar.

7. Nëpërmjet vlerësimit përcaktohen kategoritë e kreditorëve, sipas radhës së shlyerjes së detyrimit, në bazë të legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, në rastin e fillimit të procedurave të likuidimit të detyruar, dhe përfitimet e mundshme të secilës kategori të aksionarëve dhe kreditorëve, në rast se do të zbatohej likuidimi i detyruar.

8. Në rastet kur për shkak të rrethanave emergjente nuk është i mundur respektimi i kërkesave të pikave 5 dhe 6, zbatohet vlerësimi i përkohshëm, sipas pikës 2, të këtij neni. Vlerësimi i përkohshëm duhet të përmbushë kërkesat e pikës 3 dhe, për aq sa është e mundur, kërkesat e pikave 1, 5 dhe 6 të këtij neni.

Vlerësimi i përkohshëm, i përmendur në këtë pikë, përfshin një rezervë për mbulimin e humbjeve shtesë, që mund të vërtetohen në vlerësimin përfundimtar.

9. Vlerësimi i përkohshëm zbatohet derisa një vlerësues i pavarur të kryejë një vlerësim që të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e këtij neni (vlerësimi *ex-post*). Ky vlerësim *ex-post* duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Qëllimi i vlerësimit përfundimtar *ex-post* është:

a) të sigurojë që çdo humbje mbi aktivet e bankës të pasqyrohet plotësisht në librat kontabël të bankës;

b) të sigurojë informacionin e nevojshëm për marrjen e vendimit për zhvlerësimin e pretendimeve të kreditorëve apo për rritjen e vlerës së shpërblimit që paguhet, në zbatim të pikës 7 të këtij neni.

10. Në rast se vlerësimi përfundimtar *ex-post* përcakton se vlera neto e aktiveve të bankës është më e lartë se ajo e përcaktuar në vlerësimin e përkohshëm, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë:

a) të rritë vlerën e pretendimeve të kreditorëve apo zotëruesve të instrumenteve përkatëse të kapitalit, të cilët janë prekur nga zbatimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda;

b) të urdhërojë bankën urë ose shoqërinë për administrimin e aktiveve që t'u bëjë aksionarëve apo zotëruesve të instrumenteve të tjera të pronësisë pagesa të tjera në lidhje me aktivet, të drejtat, detyrimet e bankës në lidhje me aksionet apo instrumentet e pronësisë.

11. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përzgjedh vlerësuesin e pavarur për të kryer vlerësimin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe shpërblimi për kryerjen e këtij vlerësimi përballohet nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

12. Përcaktimet e këtij neni zbatohen edhe për vlerësimin e pavarur të aktiveve e të detyrimeve të një subjekti të grupit bankar.

13. Vlerësimi është pjesë e vendimit për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Ndaj vlerësimit të kryer, sipas këtij neni, mund të bëhet ankim së bashku me ankimin e vendimit për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, sipas rregullave të parashikuara në nenin 68 të këtij ligji.

14. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së vlerësuesit dhe kryerjen e vlerësimit, sipas këtij neni.

SEKSIONI 2
INSTRUMENTET E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 25
Parimet e përgjithshme të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë si më poshtë:
a) shitja e aktivitetit tregtar;
b) banka urë;
c) ndarja e aktiveve;
ç) rikapitalizimi nga brenda.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, individualisht ose të kombinuara. Zbatimi i instrumentit të ndarjes së aktiveve zbatohet i kombinuar me një nga instrumentet e tjera të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Kur janë përdorur vetëm instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të referuara në shkronjat "a" ose "b", të pikës 1, të këtij neni, për të transferuar vetëm një pjesë të aktiveve, të drejtave ose detyrimeve të bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, banka, së cilës i janë transferuar aktivet, të drejtat apo detyrimet, likuidohet sipas procedurave të likuidimit të detyruar.

4. Procedura e likuidimit të detyruar, në lidhje me pavlefshmëritë ose moszbatimin e veprimeve juridike që cenojnë të drejtat e kreditorëve, nuk do të zbatohet për transferimin e aktiveve, të drejtave ose detyrimeve nga një bankë, e cila është vendosur në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave mund të rimarrin të gjitha shpenzimet e arsyeshme, të bëra rregullisht në lidhje me përdorimin e instrumenteve dhe kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose të një instrumenti të mbështetjes financiare publike të jashtëzakonshme, si shumë e zbritshme nga çdo kundërvlerë e paguar nga marrësi për bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose për zotëruesit e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë ose si rrjedhojë e pozicionit në radhën e shlyerjes së detyrimit në likuidimin e detyruar.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet e një krize sistemike, mund të kërkojë fonde nga burime alternative të financimit nëpërmjet përdorimit të mbështetjes financiare publike të jashtëzakonshme, të parashikuar në nenet 43 dhe 44, të këtij ligji, vetëm në rastet kur aksionarët dhe zotëruesit e instrumenteve të tjera të pronësisë, zotëruesit e instrumenteve përkatëse të kapitalit dhe detyrimeve të tjera të lejueshme kanë kontribuar për përthithjen e humbjes dhe rikapitalizimin e bankës, nëpërmjet ushtrimit të kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit ose mënyrave të tjera me jo më pak se 6 për qind të totalit të detyrimeve, përfshirë edhe kapitalin rregullator, të vlerësuara në kohën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

SEKSIONI 3
INSTRUMENTI I SHITJES SË AKTIVITETIT TREGTAR

Neni 26
Shitja e aktivitetit tregtar

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, nëpërmjet instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar, ka të drejtë t'i shesë një blerësi, i cili nuk është një bankë urë:
a) aksione ose instrumente të tjera të pronësisë, të emetuara nga banka, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme; dhe/ose
b) pjesërisht ose të gjitha aktivet, të drejtat ose detyrimet e kësaj banke.

2. Shitja e aktivitetit tregtar, sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet pa marrë pëlqimin e aksionarëve të bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ose ndonjë pale të tretë, e ndryshme nga blerësi, dhe në këtë rast nuk zbatohen kërkesat e legjislacionit tregtar dhe atij të titujve, përveç atyre të parashikuara në këtë ligj.

3. Shitja e aktivitetit tregtar, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet sipas kushteve tregtare, si dhe duke marrë parasysh rrethanat konkrete.

4. Çdo shumë e paguar nga blerësi është në favor:
a) të pronarëve të aksioneve ose të instrumenteve të tjera të pronësisë, kur është

zbatuar instrumenti i shitjes së aktivitetit tregtar nëpërmjet transferimit te blerësi të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, të emetuara nga banka, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) të bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kur është zbatuar instrumenti i shitjes së aktivitetit tregtar nëpërmjet shitjes te blerësi të disa ose të gjitha aktiveve ose detyrimeve të bankës.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, kur zbaton instrumentin e shitjes së aktivitetit tregtar, mund të bëjë shitje plotësuese të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, të emetuara nga banka, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ose, siç mund të jetë rasti, aktivet, të drejtat dhe detyrimet e bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pas përdorimit të instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar, me pëlqimin e blerësit, mund të ushtrojë kompetencat e transferimit në lidhje me aktivet, të drejtat ose detyrimet e transferuara te blerësi, në mënyrë që t'i kthejë përsëri aktivet, të drejtat dhe detyrimet te banka, e cila i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ose aksionet apo instrumentet e tjera të pronësisë te pronarët e tyre të mëparshëm dhe këta të fundit janë të detyruar t'i rimarrin këto aktive, të drejta ose detyrime apo aksione ose instrumente të tjera të kapitalit.

7. Shitja e aktivitetit tregtar, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, kryhet ndaj blerësit që është i pajisur me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, në të kundërt Autoriteti Mbikëqyrës vlerëson kërkesën për licencim të blerësit brenda një afati të arsyeshëm.

8. Kur transferimi i aksioneve apo instrumenteve të tjera të pronësisë rezulton në blerjen dhe/ose rritjen e pjesëmarrjes influencuese në një bankë, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Autoriteti Mbikëqyrës kryen miratimin e kërkuar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mos vonohet ose të mos pengohet zbatimi i instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar dhe për të siguruar arritjen e objektivave përkatës të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

9. Nëse Autoriteti Mbikëqyrës nuk e ka përfunduar vlerësimin e përmendur në pikat 6 dhe 7, të këtij neni, nga data e transferimit të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, gjatë përdorimit të instrumentit të shitjes së aktivitetit lindin efektet juridike të mëposhtme:

a) transferimi i tillë i aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë te marrësi prodhon pasoja të menjëhershme ligjore;

b) gjatë periudhës së vlerësimit dhe gjatë periudhës së ritransferimit, të parashikuar në shkronjën "dh", të kësaj pike, të drejtat e votës së blerësit që lidhen me këto aksione apo instrumente të tjera të pronësisë pezullohen dhe ushtrohen vetëm nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, por i cili nuk mban asnjë përgjegjësi për ushtrimin apo mosushtrimin e këtyre të drejtave të votës;

c) gjatë periudhës së vlerësimit dhe gjatë periudhës së ritransferimit, të parashikuar në shkronjën "dh", të kësaj pike, masat për shkeljen e kërkesave për marrjen e miratimit paraprak për pjesëmarrjet influencuese, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, nuk zbatohen për një transferim të tillë të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë;

ç) menjëherë pas përfundimit të vlerësimit, Autoriteti Mbikëqyrës njofton me shkrim blerësin nëse e miraton apo jo këtë transferim të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë te blerësi;

d) nëse Autoriteti Mbikëqyrës miraton transferimin e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë te blerësi, atëherë të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione ose instrumente të tjera të pronësisë konsiderohet se i takojnë plotësisht blerësit, menjëherë pas marrjes së njoftimit të dhënies së miratimit nga Autoriteti Mbikëqyrës;

dh) nëse Autoriteti Mbikëqyrës nuk e miraton transferimin e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë te blerësi, atëherë:

i) të drejtat e votës që i japin këto aksione ose instrumente të tjera të pronësisë, siç parashikohen nga shkronja "b", e kësaj pike, qëndrojnë në fuqi të plotë;

ii) Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund t'i kërkojë blerësit t'i ritransferojë këto aksione ose instrumente të tjera të pronësisë brenda një afati të përcaktuar, duke mbajtur në konsideratë kushtet mbizotëruese në treg; dhe

iii) nëse blerësi nuk e kryen këtë ritransferim të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë brenda afatit të vendosur nga Autoriteti i

Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, atëherë Autoriteti vendos mbi blerësin penalitetet dhe masat e tjera për shkeljen e kërkesave për pjesëmarrjen influencuese, si dhe lindin efektet juridike të parashikuara në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

10. Transferimet e bëra në bazë të instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar realizohen duke respektuar masat mbrojtëse, të parashikuara në nenet 56-63, të këtij ligji.

11. Blerësi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, mund të vazhdojë të ushtrojë të drejtat e anëtarësisë dhe aksesit në sistemin e pagesave, kleringut dhe të shlyerjes dhe skemave të sigurimit të depozitave të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, me kusht që blerësi të plotësojë kriteret dhe kushtet e anëtarësimit e të pjesëmarrjes në sisteme të tilla.

12. Pavarësisht nga përcaktimet në pikën 9, të këtij neni, për trajtimin e aksionarëve e të kreditorëve, aksionarët ose kreditorët e bankës në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe palët e tjera të treta, të cilave nuk u janë transferuar aktivet, të drejtat ose detyrimet, nuk do të kenë asnjë të drejtë mbi ose në lidhje me aktivet, si dhe të drejtat ose detyrimet e transferuara.

Neni 27

Kërkesat procedurale për shitjen e aktivitetit tregtar

1. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton instrumentin e shitjes së aktivitetit tregtar për një bankë, ai bën marketing ose organizon bërjen e marketingut për ato aktive, të drejta, detyrime, aksione ose instrumente të tjera të pronësisë së bankës që autoriteti synon të shesë. Grupimet e të drejtave, aktiveve dhe detyrimeve mund të marketohen më vete.

2. Marketingu i përmendur në pikën 1, të këtij neni, kryhet në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) të jetë sa më transparent dhe të bëjë një pasqyrim real të aktiveve, të drejtave, të pasiveve, të aksioneve ose të instrumenteve të tjera të pronësisë të bankës, të cilat autoriteti synon t'i shesë, duke mbajtur në konsideratë rrethanat dhe në veçanti nevojën për të ruajtur stabilitetin financiar;

b) të mos favorizojë ose të mos diskriminojë blerësit e mundshëm;

c) të mos ketë asnjë konflikt interesi;

ç) të mos i japë përparësi të padrejtë një blerësi të mundshëm;

d) të mbajë në konsideratë nevojën për të realizuar një veprim të shpejtë për zgjidhjen;

dh) të synojë të maksimizojë sa më shumë çmimin e shitjes për aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë, aktivet, të drejtat ose pasivet e përfshira.

Me përjashtim të kriterit të parashikuar në shkronjën "b", të kësaj pike, parimet e tjera të përmendura në këtë pikë nuk e pengojnë Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme të kërkojë blerës të mundshëm. Shpenzimet e marketingut përballohen nga banka.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton instrumentin e shitjes së aktivitetit edhe pa përmbushur kërkesat për realizimin e marketingut, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në rastin kur:

a) përmbushja e këtyre kërkesave mund të bëjë të parealizueshëm një ose më shumë prej objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) stabiliteti financiar kërcënohet nga një rrezik me rëndësi materiale, i cili shkaktohet nga fakti që banka konsiderohet të jetë pranë një situate të paaftësisë paguese;

c) ka ndikim negativ në efektivitetin e instrumentit të shitjes së aktivitetit.

SEKSIONI 4
INSTRUMENTI I BANKËS URË

Neni 28

Banka urë

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme krijon bankën urë, duke i transferuar të drejtën e pronësisë mbi aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë, aktivet, të drejtat dhe detyrimet e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, me qëllim ruajtjen e funksioneve kritike të bankës.

2. Banka urë është person juridik, që përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) është tërësisht ose pjesërisht në pronësi të një ose më shumë autoriteteve publike, si dhe kontrollohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

b) krijohet me qëllim të zotërimit të një pjese ose të të gjitha aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë apo disa ose të gjitha aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të bankës, objekt i

ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim ruajtjen e funksioneve me rëndësi kritike.

3. Vlera e përgjithshme e detyrimeve që i transferohen bankës urë nuk mund të tejkalojë vlerën totale të aktiveve që i transferohen asaj nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme apo të siguruara nga burime të tjera.

4. Transferimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, nuk kërkon miratimin e aksionarëve dhe kreditorëve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme apo ndonjë pale të tretë, të ndryshme nga banka urë, dhe nuk pengohet apo nuk kufizohet nga ndonjë kërkesë procedurale në zbatim të legjislacionit mbi shoqëritë tregtare apo për titujt.

5. Depozitat që i transferohen bankës urë vazhdojnë të jenë të siguruara, sipas parashikimeve të legjislacionit mbi sigurimin e depozitave. Me krijimin dhe licencimin e saj, banka urë është pjesë e skemës së sigurimit të depozitave, sipas parashikimeve të legjislacionit për sigurimin e depozitave.

6. Çdo shumë e paguar nga banka urë është në përfitim:

a) të zotëruesve të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, nëse transferimi te banka urë është bërë nëpërmjet transferimit të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, të emetuara nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

b) të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, nëse transferimi te banka urë është bërë nëpërmjet transferimit të të gjitha ose të disa aktiveve apo detyrimeve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

7. Në vijim të zbatimit të instrumentit të bankës urë, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund:

a) të transferojë të drejta, aktive ose detyrime nga banka urë te banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose aksionet apo instrumentet e tjera të pronësisë te zotëruesit e tyre fillestarë dhe këta të fundit janë të detyruar t'i marrin përsëri këto aktive, të drejta ose detyrime apo aksione, me kusht që të jenë plotësuar kushtet e parashikuara në pikën 8 të këtij neni;

b) të transferojë aksionet ose instrumente të tjera të pronësisë ose aktivet, të drejta apo detyrimet nga banka urë te një palë e tretë.

8. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të urdhërojë në çdo periudhë transferimin nga banka urë te zotëruesit fillestarë të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë ose aktiveve, të drejtave ose detyrimet në rastet kur:

a) mundësia, që aksione të caktuara, aktive, të drejta ose detyrime të mund të transferohen mbrapsht, është parashikuar shprehimisht në vendimin, nëpërmjet të cilit është bërë transferimi;

b) aksionet, aktivet, të drejtat ose detyrime të caktuara nuk bëjnë pjesë në kategoritë apo nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në vendimin në bazë të të cilit është bërë transferimi.

9. Transferimet midis bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, apo zotëruesve fillestarë të aksioneve, në njërën anë, dhe bankës urë, në anën tjetër, duhet të jenë në përputhje me masat mbrojtëse të parashikuara në nenet 56-63 të këtij ligji.

10. Statuti i bankës urë miratohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

11. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme emëron dhe mund të shkarkojë, në çdo kohë, administratorët e bankës urë.

12. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton strategjinë e biznesit dhe profilin e rrezikut të bankës urë, si dhe shpërblimin e pagesat e tjera për administratorët e saj.

13. Banka urë konsiderohet vazhdim i bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dhe vazhdon të ushtrojë çdo të drejtë që është ushtruar prej saj në lidhje me aktivet, të drejtat ose detyrimet e transferuara, si dhe veprimtaritë dhe shërbimet ndihmëse të lidhura me to, siç përcaktohet në vendimin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

14. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr masa që banka urë të përfundojë veprimtarinë jo më vonë se 2 vjet pas krijimit të saj.

15. Autoriteti Mbikëqyrës përcakton me akt nënligjor mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së bankës urë, licencimin, mbikëqyrjen dhe rastet e përfundimit të veprimtarisë së bankës urë. Autoriteti Mbikëqyrës ka të drejtë të përcaktojë kërkesa më të lehtësuara për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankës urë, në krahasim me kërkesat e përcaktuara për bankat e tjera, në fillimet e ushtrimit të veprimtarisë së saj.

16. Organet e administrimit dhe drejtuesit e bankës urë nuk mbajnë përgjegjësi ndaj aksionarëve ose kreditorëve të bankës në ndërhyrje të

jashtëzakonshme, me përjashtim të rasteve kur veprimet ose mosveprimet vijnë nga neglizhenca ose gabime të rënda, të cilat kanë pasoja të drejtpërdrejta për këta aksionarë. Ata kryejnë detyrat e tyre me kujdesin e nevojshëm në lidhje me aktivet dhe detyrimet e transferuara dhe i raportojnë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, sipas afateve dhe mënyrave të përcaktuara në akt nënligjor të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

17. Parashikimet e legjislacionit tregtar, legjislacionit për titujt, si dhe ligjeve të tjera në fuqi nuk zbatohen nëse nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë.

SEKSIONI 5
INSTRUMENTI I NDARJES SË AKTIVEVE

Neni 29
Ndarja e aktiveve

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të vendosë që aktivet, të drejtat dhe detyrimet e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të bankës urë t'i transferohen një personi tjetër juridik, i cili nuk është bankë urë dhe që do të referohet në këtë ligj si shoqëria për administrimin e aktiveve, nëse plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) situata në treg për këto aktive është e tillë që shitja e tyre gjatë procedurës së likuidimit të detyruar do të kishte një efekt negativ në tregun financiar;

b) ky transferim është i nevojshëm për të siguruar mirëfunksionimin e bankës, aktivet e së cilës janë transferuar;

c) ky transferim është i nevojshëm për të maksimizuar të ardhurat nga likuidimi.

2. Transferimi i parashikuar në pikën 1 kryhet pa marrë miratimin e aksionarëve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme apo të ndonjë pale të tretë dhe pa ndjekur kërkesat procedurale, sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare apo për titujt.

3. Në kuadër të instrumentit për ndarjen e aktiveve, një shoqëri për administrimin e aktiveve është një person juridik që përmbush të gjitha kriteret e mëposhtme:

a) është themeluar në formën e shoqërisë aksionare, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;

b) zotërohet tërësisht ose pjesërisht nga një ose më shumë subjekte publike dhe kontrollohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

c) është krijuar me qëllim marrjen e disa ose të gjitha aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të një apo më shumë bankave që janë vendosur në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të një banke urë.

4. Shoqëria e administrimit të aktiveve administron aktivet që i janë transferuar, me qëllim maksimizimin e vlerës së tyre nëpërmjet shitjes.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme miraton:

a) dokumentet e themelimit të shoqërisë së administrimit të aktiveve;

b) emërimin e organeve drejtuese të shoqërisë së administrimit të aktiveve;

c) shpërblimin dhe dokumentin që përcakton kompetencat e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë së administrimit të aktiveve;

ç)strategjinë dhe profilin e rrezikut të shoqërisë së administrimit të aktiveve.

6. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton instrumentin e ndarjes së aktiveve, ai përcakton çmimin në këmbim të të cilit aktivet, të drejtat dhe detyrimet i transferohen shoqërisë së administrimit të aktiveve në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 24, të këtij ligji. Kjo dispozitë nuk ndalon që çmimi të ketë një vlerë nominale ose negative.

7. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme urdhëron transferimin përsëri te banka, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, aktivet dhe detyrimet, me kusht që:

a) mundësia, që aktivet, të drejtat ose detyrimet të mund të transferohen mbrapsht, të jetë parashikuar shprehimisht në vendimin, nëpërmjet të cilit është bërë transferimi;

b) aktivet, të drejtat ose detyrimet e caktuara nuk bëjnë pjesë në kategoritë apo nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në vendimin, në bazë të të cilit është bërë transferimi.

8. Organet e administrimit dhe drejtuesit e shoqërisë së administrimit të aktiveve nuk mbajnë përgjegjësi ndaj aksionarëve ose kreditorëve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, me përjashtim të rasteve kur veprimet ose mosveprimet vijnë nga neglizhenca ose gabime të rënda, të cilat kanë pasoja të drejtpërdrejta për këta aksionarë. Ata kryejnë detyrat e tyre në lidhje me aktivet dhe detyrimet e transferuara me kujdesin e

nevojshëm dhe i raportojnë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, sipas afateve dhe mënyrave të përcaktuara në vendimin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

9. Shoqëria për administrimin e aktiveve, e krijuar sipas këtij neni, përjashtohet si subjekt i dispozitave të legjislacionit në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

10. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor kushtet dhe mënyrën e krijimit e të funksionimit të shoqërisë së administrimit të aktiveve.

SEKSIONI 6
INSTRUMENTI I RIKAPITALIZIMIT NGA BRENDA

Neni 30
Rikapitalizimi nga brenda

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të zbatojë instrumentin e rikapitalizimit nga brenda, në përputhje me parimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për arritjen e qëllimeve të mëposhtme:

a) rikapitalizimin e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme për të përmbushur kushtet për vazhdimësinë e kryerjes së veprimtarive, për të cilat është licencuar, si dhe për ruajtjen e nivelit të besimit të tregut për bankën; dhe/ose

b) zhvlerësimin ose konvertimin në kapital të detyrimeve ose titujve të borxhit që i janë transferuar bankës urë, me qëllim sigurimin e kapitalit të saj ose që janë transferuar në kuadër të instrumentit të shitjes së aktivitetit të bankës ose të instrumentit të ndarjes së aktiveve;

c) rivendosjen e bankës në gjendje të mirë financiare dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të saj.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të përdorë njëkohësisht instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të përmendura në shkronjat "a", "b", e "c", të pikës 1, të nenit 25, të këtij ligji, dhe instrumentin e rikapitalizimit nga brenda për të përmbushur kërkesat e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, në rast se nuk përmbushet qëllimi i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni.

Neni 31
Qëllimi i rikapitalizimit nga brenda

1. Instrumenti i rikapitalizimit nga brenda mund të zbatohet për të gjitha detyrimet e bankës që nuk janë përjashtuar nga fusha e zbatimit të këtij instrumenti, siç përcaktohet në pikat 2 ose 4 të këtij neni.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nuk mund të ushtrojë kompetencat e zhvlerësimit ose të konvertimit për detyrimet e mëposhtme të bankës:

a) detyrimet që rrjedhin nga depozitat e siguruara deri në nivelin maksimal të mbulimit, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin e depozitave;

b) detyrimet e siguruara me hipotekë, peng, barrë siguruese, kolateral financiar ose të drejta reale të tjera të ngjashme, duke përfshirë veprimet *repo*, obligacionet e garantuara dhe detyrimet në formën e instrumenteve financiare të përdorura për qëllime mbrojtjeje (*hedging)*;

c) detyrimet që rrjedhin nga administrimi i aktiveve të klientëve, të mbajtura për llogari të një fondi investimesh ose fondi pensionesh nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

ç) detyrime ndaj bankave vendase ose të huaja dhe shoqërive të investimeve, me një afat maturimi fillestar prej më pak se shtatë ditësh, duke përjashtuar subjektet që janë pjesë e të njëjtit grup bankar;

d) detyrimet ndaj sistemeve të pagesave, të klerimit dhe shlyerjes, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për sistemin e pagesave, si sisteme dhe/ose operatorë të rëndësishëm të pjesëmarrësve në këto sisteme dhe që lindin nga pjesëmarrja në këto sisteme, të cilave u kanë mbetur më pak se shtatë ditë deri në datën e maturimit;

dh) detyrime ndaj punëmarrësve që rrjedhin nga paga, pensioni ose çdo shpërblim tjetër fiks, të maturuara dhe të papaguara, me përjashtim të pjesës së pagës që lidhet me kontributin e punëmarrësit në suksesin e aktivitetit të punëdhënësit (shpërblime, bonuse etj.) dhe të përbërësve të tjerë variabël të shpërblimit;

e) detyrime ndaj kreditorëve, të cilët i kanë shitur produkte ose i kanë ofruar shërbime bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të cilat janë të domosdoshme për vazhdimin e aktivitetit të

përditshëm, duke përfshirë shërbimet e teknologjisë së informacionit, shërbimet utilitare dhe ato të mirëmbajtjes e marrjes me qira të ambienteve;

ë) detyrimet tatimore dhe detyrimet në lidhje me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore;

f) detyrimet ndaj Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe kontributin për "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pavarësisht nga përcaktimi i shkronjës "b", të pikës 2, të këtij neni, mund gjithashtu që të zbatojë instrumentin e rikapitalizimit nga brenda ndaj çdo pjese të detyrimeve që tejkalon vlerën e sendit ose të së drejtës, që garanton detyrimin.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 2, të këtij neni, në rrethana të jashtëzakonshme, kur përdoret instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, mund të përjashtojë plotësisht ose pjesërisht disa detyrime të caktuara nga zhvlerësimi ose konvertimi, në rastet e mëposhtme:

a) kur detyrimi nuk mund të zhvlerësohet ose të konvertohet në kapital brenda një kohe të arsyeshme, pavarësisht nga veprimet e nevojshme që Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të ndërmerrte për këtë qëllim;

b) kur përjashtimi është i nevojshëm për vazhdimësinë e funksioneve kritike dhe veprimtarive kryesore të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

c) kur përjashtimi është i nevojshëm për të shmangur çdo impakt negativ mbi stabilitetin e sistemit financiar;

ç) kur zhvlerësimi dhe konvertimi në kapital i detyrimeve shkakton një zvogëlim të tillë të vlerës, aq sa humbjet e pësuara nga kreditorët e tjerë do të ishin më të larta sesa detyrimet e përjashtuara nga zhvlerësimi ose konvertimi në kapital.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur përjashton pjesërisht ose tërësisht një detyrim të pranuar nga zhvlerësimi ose konvertimi në kapital, në përputhje me këtë nen, si dhe nëse humbjet që do të mbuloheshin nga ushtrimi i kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit të këtyre detyrimeve nuk u janë transferuar tërësisht kreditorëve të tjerë, mund të përdorë "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme" për qëllimet e mëposhtme:

a) për të mbuluar këto humbje dhe për rivendosjen e vlerës neto zero të aktiveve të bankës;

b) për të blerë aksione ose instrumente të tjera të pronësisë së bankës, me qëllim rikapitalizimin e saj.

6. "Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme" mund të përdoret në funksion të qëllimeve të përcaktuara në pikën 5, të këtij neni, vetëm në rast se:

a) aksionarët dhe kreditorët e tjerë të kenë përthithur humbjet dhe të jetë kryer rikapitalizimi në një vlerë jo më të vogël se 6 për qind të të gjitha detyrimeve, duke përfshirë kapitalin rregullator të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të llogaritur në momentin e veprimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me vlerësimin e parashikuar në nenin 24 të këtij ligji;

b) kontributi i "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" të mos jetë më shumë se 5 për qind të të gjithë detyrimeve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, përfshirë edhe kapitalin rregullator.

7. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor kushtet dhe mënyrën për ushtrimin e kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit në bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe rastet përjashtimore të pikës 6 të këtij neni.

Neni 32

Kërkesa minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara

1. Banka duhet të plotësojë në çdo kohë kërkesat për nivelin minimal të instrumenteve të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuara.

2. Kërkesa për nivelin minimal, të parashikuar nga pika 1, e këtij neni, llogaritet si shuma e instrumenteve të kapitalit rregullator dhe e detyrimeve të pranuara, e shprehur si përqindje e të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës. Në kuptim të kësaj pike, detyrimet që rrjedhin nga transaksionet me produkte derivative përfshihen në totalin e detyrimeve, duke njohur plotësisht të drejtat për kompensim të palës tjetër.

3. Detyrimet e pranuara konsiderohen detyrimet e bankës, të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) instrumenti është i emetuar dhe plotësisht i paguar;

b) instrumenti nuk është emetuar me të drejtë riblerjeje dhe/ose nuk është i garantuar nga vetë banka;

c) blerja e instrumentit nuk është financuar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga banka;

ç) detyrimi ka një afat të mbetur shlyerjeje prej të paktën një viti;

d) detyrimi nuk lind nga produkte derivative;

dh) detyrimi nuk lind nga një depozitë e siguruar, e cila ka përparësi në radhën e shlyerjes së detyrimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë.

4. Në kuptim të shkronjës "ç", të pikës 3, të këtij neni, kur detyrimi i njeh kreditorit të drejtën të kërkojë pagimin para afatit, data e shlyerjes të këtij detyrimi është data e parë kur lind kjo e drejtë.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuara të çdo banke, mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

Neni 33

Vlerësimi i shumës së rikapitalizimit nga brenda

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, kur zbaton instrumentin e rikapitalizimit nga brenda, bazohet në vlerësimin e kryer në bazë të nenit 24, të këtij ligji, duke agreguar:

a) shumën e zhvlerësimit që do t'u bëhet detyrimeve të pranuara, me qëllim vendosjen e vlerës neto zero për aktivet e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme; dhe

b) shumën e vlerës së detyrimeve të pranuara që mund të konvertohen në aksione ose në instrumente të tjera kapitali, me qëllim rivendosjen e raportit të kërkuar për kapitalin e nivelit të parë të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të bankës urë.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, përcakton shumën me të cilën detyrimet e pranuara zhvlerësohen ose konvertohen në kapital, me qëllim arritjen e nivelit të kërkuar të kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose, në rastin e bankës urë, të mundësojë vazhdimin e aktivitetit të saj për të paktën një vit.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur zbaton instrumentin e ndarjes së aktiveve, sipas nenit 29, të këtij ligji, në përcaktimin e shumës me të cilën nevojitet të zhvlerësohen detyrimet e pranuara, duhet të marrë në konsideratë edhe një vlerësim të kujdesshëm të nevojave për kapital të shoqërisë së administrimit të aktiveve.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të përdorë një mekanizëm rivlerësimi për të rimbursuar kreditorët dhe pastaj aksionarët, kur pas vlerësimit përfundimtar, të përcaktuar në nenin 24, të këtij ligji, konstatohet se shuma e përdorur për zbatimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda tejkalon kërkesat për rikapitalizim.

Neni 34

Trajtimi i aksionarëve gjatë rikapitalizimit nga brenda ose ushtrimit të kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, në përputhje me nenin 30, të këtij ligji, ose ushtrimit të kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit të instrumenteve të kapitalit, në përputhje me nenin 46, të këtij ligji, ndërmerr një ose të dyja veprimet e mëposhtme në lidhje me aksionarët dhe mbajtësit e instrumenteve të tjera të pronësisë:

a) anulon aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë ose transferon aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë te kreditorët e bankës që është vendosur në ndërhyrje të jashtëzakonshme; ose

b) nëse, në përputhje me vlerësimin e bërë, sipas nenit 24, të këtij ligji, aktivet e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme janë në një vlerë më të lartë se detyrimet (vlerë neto pozitive), zvogëlon pjesëmarrjen e aksionarëve ekzistues duke kthyer në aksione ose instrumente të tjera të pronësisë si më poshtë:

i) instrumentet e kapitalit të emetuara nga banka, në përputhje me kompetencat e parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;

ii) detyrimet e pranuara, të emetuara nga banka që është vendosur në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me shkronjën "dh", të pikës 1, të nenit 47, të këtij ligji.

2. Zvogëlimi i pjesëmarrjes së aksionarëve ekzistues, bazuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, kryhet mbi bazën e një raporti konvertimi.

3. Veprimet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ndërmerren gjithashtu dhe për aksionarët apo zotëruesit e instrumenteve të tjera të pronësisë kur aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë janë emetuar apo dhënë:

a) me anë të konvertimit të titujve të borxhit në aksione ose instrumente të tjera të pronësisë, i cili është kryer, në përputhje me kontratën përkatëse, me ndodhjen e një ngjarjeje që ka paraprirë ose ka ndodhur në të njëjtën kohë me miratimin e vendimit për të filluar procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme; dhe

b) me anë të konvertimit të titujve të kapitalit në tituj të kapitalit të nivelit të parë, në përputhje me nenin 46 të këtij ligji.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me qëllim përcaktimin e veprimeve, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, merr në konsideratë:

a) vlerësimin e kryer në përputhje me nenin 24 të këtij ligji;

b) vlerësimin e shumës, me të cilën duhet të zvogëlohen zërat e kapitalit të zakonshëm të nivelit të parë dhe/ose të zhvlerësohen ose konvertohen në instrumente përkatëse të kapitalit, në bazë të pikës 1, të nenit 46, të këtij ligji; dhe

c) shumën agregate, të vlerësuar në bazë të nenit 33 të këtij ligji.

5. Autoriteti Mbikëqyrës, në rastet kur konvertimi i titujve të kapitalit sjell si pasojë rritjen e pjesëmarrjes influencuese, jep miratimin paraprak vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë dhe brenda një afati që nuk sjell vonesa në zbatimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda apo nuk pengon në arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

6. Për qëllime të këtij neni, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) me shprehjen "transferim i aksioneve ose instrumenteve të tjera ekzistuese të pronësisë te kreditorët e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme", të përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, kuptohet transferimi i aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë te kreditorët e bankës, të cilët janë prekur nga zbatimi i instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përfundimi i pretendimeve financiare dhe i të drejtave të pronësisë të aksionarëve të prekur;

b) me termin "zvogëlim i nivelit të pjesëmarrjes të aksionarëve ekzistues", të përmendur në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, kuptohet zvogëlimi proporcionalisht i pretendimeve financiare dhe i të drejtave të pronësisë të aksionarëve ekzistues, si pasojë e emetimit të aksioneve ose instrumenteve të reja të pronësisë.

Neni 35

Radha e zhvlerësimit dhe konvertimit në kapital të detyrimeve

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë përdorimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda ushtron kompetencat e zhvlerësimit dhe të konvertimit, sipas radhës së mëposhtme:

a) zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë zhvlerësohen në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 46, të këtij ligji;

b) nëse zhvlerësimi i kryer në bazë të shkronjës "a", të kësaj pike, është më i vogël se shuma e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 34, të këtij ligji, pakëson vlerën principale të instrumenteve të nivelit të parë shtesë;

c) nëse zhvlerësimi i kryer në bazë të shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, është më i vogël se shuma e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 34, të këtij ligji, pakëson vlerën principale të instrumenteve të nivelit të dytë;

ç) nëse zhvlerësimi i aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë dhe instrumenteve përkatëse të kapitalit, i kryer në bazë të shkronjave "a", "b" dhe "c", të kësaj pike, është më i vogël se shuma e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 34, të këtij ligji, atëherë pakëson vlerën principale të borxhit të varur që nuk është kapital i nivelit të parë shtesë ose i nivelit të dytë, në përputhje me radhën e shlyerjes së detyrimeve në procedurën e likuidimit të detyruar, bashkë me zhvlerësimin e bërë sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të kësaj pike, për të arritur shumën e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 34, të këtij ligji;

d) nëse zvogëlimi gjithsej i aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë dhe instrumenteve përkatëse të kapitalit e të detyrimeve të pranuara, i kryer në bazë të shkronjave "a", "b", "c" dhe "ç", të kësaj pike, që është më i vogël se shuma e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 34, të këtij ligji, zvogëlon vlerën principale ose shumën e detyrimeve të tjera, të pranuara në përputhje me

radhën e shlyerjes së detyrimeve të kërkueshme në procesin e likuidimit të detyruar, përfshirë renditjen e depozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, në bazë të nenit 31, të këtij ligji, bashkë me zhvlerësimin e bërë në bazë të shkronjave "a", "b", "c" dhe "ç", të kësaj pike, për të arritur shumën e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenin 34, të këtij ligji.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë zbatimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit, i shpërndan humbjet e rezultuara nga shuma e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 34, të këtij ligji, në mënyrë të barabartë midis aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë dhe detyrimeve të pranuara të së njëjtës radhë të shlyerjes së detyrimeve, duke e zvogëluar shumën principale ose shumën ende të pashlyer të këtyre aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë dhe detyrimeve të pranuara në të njëjtën shkallë në përpjesëtim me vlerën e tyre, me përjashtim të rastit kur një lloj tjetër shpërndarjeje e humbjeve mes detyrimeve të së njëjtës radhë të shlyerjes së detyrimeve lejohet në rrethanat e përcaktuara në pikën 4, të nenit 31, të këtij ligji.

Në zbatim të kësaj pike, detyrimet që janë përjashtuar nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, në bazë të pikave 2 dhe 4, të nenit 31, të këtij ligji, mund të përfitojnë trajtim më të favorshëm se detyrimet e pranuara që janë të së njëjtës radhë të shlyerjes së detyrimeve, në proces likuidimi të detyruar.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, përpara përdorimit të zhvlerësimit ose konvertimit në kapital të detyrimeve të përmendura në shkronjën "e", të pikës 1, të këtij neni, konverton detyrimet në kapital ose pakëson vlerën principale të instrumenteve të përmendura në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij neni, kur këto instrumente nuk janë konvertuar ende dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) parashikojnë që vlera principale e instrumentit të zvogëlohet nëse ndodh një ngjarje që ka të bëjë me situatën financiare, aftësinë paguese ose nivelet e kapitalit rregullator të bankës;

b) parashikojnë konvertimin e instrumenteve në aksione ose instrumenteve të tjera të pronësisë nëse ndodh një ngjarje e tillë.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur është zvogëluar vlera principale e një instrumenti, por pa u bërë zero, në bazë të kushteve të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 3, të këtij neni, përpara zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, sipas pikës 1, ushtron kompetencat e zhvlerësimit dhe të konvertimit për vlerën e mbetur të principalit.

5. Në rastet kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos për zhvlerësimin apo konvertimin në kapital të një klase detyrimesh, prek fillimisht atë klasë detyrimesh që ka radhë të shlyerjes së detyrimeve më të ulët, nëse nuk përcaktohet ndryshe në pikat 2 dhe 4, të nenit 31, të këtij ligji.

Neni 36
Produktet derivative

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron kompetencat e zhvlerësimit dhe të konvertimit të detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet mbi produktet derivative vetëm pas përfundimit të këtyre marrëveshjeve.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë të përfundojë detyrimet e marrëveshjeve mbi produktet derivative në datën e vendimit, i cili vendos bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 2, të këtij neni, nuk është i detyruar të përfundojë dhe të kompensojë *(netting)* një marrëveshje mbi produktet derivative nëse detyrimet që rrjedhin nga këto marrëveshje janë përjashtuar nga zbatimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, në përputhje me pikën 4, të nenit 31, të këtij ligji.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ose një vlerësues i pavarur, në rastet kur marrëveshjet mbi produktet derivative i nënshtrohen një marrëveshjeje kompensimi *netting*, në përputhje me nenin 24, të këtij ligji, përcakton detyrimin që rrjedh nga këto transaksione, në përputhje me marrëveshjen e kompensimit.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton vlerën e detyrimeve që lindin nga produktet derivative në përputhje me:

a) metodologjinë e duhur për përcaktimin e vlerës së klasës së produkteve derivative, përfshirë edhe transaksionet që janë objekt i kontratave të rregullimit të llogarive;

b) parimet për gjetjen e momentit përkatës, në të cilin duhet përcaktuar pozicioni i një produkti derivativ; dhe

c) metodologjinë e duhur për krahasimin e rënies së vlerës që shkaktohet nga mbyllja dhe rikapitalizimi nga brenda i produkteve derivative me shumën e humbjeve që do të mbuloheshin nga derivativët në rastin e rikapitalizimit nga brenda.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor metodologjinë për përcaktimin e vlerës së detyrimeve që rrjedhin nga produktet derivative.

Neni 37

Raporti i konvertimit të detyrimeve në kapital

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur vepron në përputhje me përcaktimin e shkronjës "dh", të pikës 1, të nenit 47, të këtij ligji, mund të zbatojë një raport konvertimi të ndryshëm për secilën kategori të instrumenteve të kapitalit dhe detyrimeve, sipas parimeve, të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Raporti i konvertimit përbën kompensimin e duhur për kreditorët e prekur për çdo humbje që rrjedh nga ushtrimi i kompetencave të zhvlerësimit dhe të konvertimit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Në rastet kur përdoren raporte të ndryshme konvertimi, sipas pikës 1, të këtij neni, raporti i konvertimit, i zbatueshëm për detyrimet që konsiderohen se janë më të preferuara në radhën e shlyerjes së detyrimeve, sipas procedurave të likuidimit të detyruar, është më i lartë se raporti i konvertimit të zbatuar për detyrimet e tjera.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor kriteret për përcaktimin e normave të konvertimit të borxhit në kapital.

Neni 38

Masat e rimëkëmbjes dhe riorganizimit që shoqërojnë rikapitalizimin nga brenda

1. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton instrumentin e rikapitalizimit nga brenda në një bankë, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 30, të këtij ligji, merr masa për hartimin dhe zbatimin e një plani për riorganizimin e aktivitetit tregtar të bankës, në përputhje me nenin 39, të këtij ligji.

2. Në masat organizative, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të përfshihet emërimi nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme i një ose disa administratorëve, me qëllim hartimin dhe zbatimin e planit për riorganizimin e aktivitetit tregtar, siç parashikohet në nenin 39 të këtij ligji.

Neni 39

Plani i riorganizimit të aktivitetit tregtar

1. Banka ndaj së cilës zbatohet instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, me qëllim rritjen e kapitalit aksionar, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 30, të këtij ligji, me fillimin e zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, harton një plan për riorganizimin e aktivitetit tregtar dhe ia paraqet Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në bashkëpunim me Autoritetin Mbikëqyrës, brenda një muaji nga data e paraqitjes së planit për riorganizimin e aktivitetit tregtar, vlerëson nëse zbatimi i këtij plani mund të rivendosë stabilitetin financiar të bankës.

3. Plani për riorganizimin e aktivitetit tregtar përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) një analizë të faktorëve dhe problemeve, për shkak të të cilave banka u konsiderua të jetë pranë një situate të paaftësisë paguese;

b) një përshkrim të masave që synojnë rivendosjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të bankës, e cila zbaton instrumentin e rikapitalizimit nga brenda;

c) afatet kohore për zbatimin e këtyre masave.

4. Në masat që synojnë rivendosjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të bankës, përmendur në shkronjën "b", të pikës 3, të këtij neni, mund të përfshihet:

a) riorganizimi i veprimtarive të bankës;

b) ndryshime të sistemeve e të infrastrukturës operative brenda bankës;

c) tërheqja nga aktivitetet që sjellin humbje;

ç)ristrukturimi i veprimtarive ekzistuese, me qëllim bërjen e tyre konkurruese;

d) shitja e aktiveve ose e veprimtarive.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në çdo rast që vlerëson se masat janë të pamjaftueshme, ka të drejtë t'i kërkojë bankës kryerjen e ndryshimeve të tjera në planin e riorganizimit të aktivitetit tregtar.

Neni 40
Efektet e rikapitalizimit nga brenda

1. Vendimi i Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për zbatimin e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda dhe ushtrimin e kompetencës së zhvlerësimit e të konvertimit në kapital hyn në fuqi nga data e përcaktuar në këtë vendim.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me qëllim ushtrimin e kompetencave të zhvlerësimit e të konvertimit në kapital, ka të drejtë të kërkojë:

a) ndryshime në regjistrat publikë përkatës;

b) pezullimin e përkohshëm të tregtimit, heqjen nga tregtimi apo listimi të aksioneve apo titujve të borxhit në një treg të rregulluar;

c) listimin e aksioneve të reja ose instrumenteve të tjera të pronësisë në një treg të rregulluar;

ç)rilistimin në një treg të rregulluar të titujve të borxhit që janë zhvlerësuar pa qenë nevoja e publikimit të një prospekti.

3. Autoritetet dhe personat që marrin kërkesën e sipërpërmendur nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbatojnë menjëherë këtë vendim.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur e zvogëlon në zero vlerën principale ose shumën e mbetur të papaguar të një detyrimi, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të parashikuara në shkronjën "dh", të pikës 1, të nenit 47, të këtij ligji, ky detyrim dhe çdo pretendim apo detyrim tjetër në lidhje me të, të cilët nuk ishin të kërkueshëm në momentin kur është ushtruar kompetenca, trajtohen si të shlyer dhe nuk mund të pretendohet në asnjë procedurë të mëvonshme, përfshirë procedurat e likuidimit të detyruar, ndaj bankës, që është objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme apo personave që i kanë kaluar të drejtat e saj.

5. Në rastet kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme e zvogëlon pjesërisht, por jo tërësisht vlerën principale ose shumën e mbetur të papaguar të detyrimit, sipas pikës 4, të këtij neni, atëherë:

a) detyrimi konsiderohet i shlyer për aq sa është zvogëluar shuma;

b) instrumenti ose kontrata përkatëse prej nga ka lindur detyrimi fillestar vazhdon të zbatohet në lidhje me vlerën e mbetur të principalit ose të shumës së mbetur pa paguar dhe, në çdo rast, është subjekt i ndryshimeve të interesit të pagueshëm në përpjesëtim me shumën e reduktuar të kryegjësë, si dhe çdo ndryshimi të kushteve nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme me anë të kompetencës së përmendur në shkronjën "f", të pikës 1, të nenit 47, të këtij ligji.

Neni 41
Heqja e pengesave procedurale për rikapitalizimin nga brenda

1. Asambleja e Aksionarëve të Bankës, me kërkesë të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, autorizon drejtorin ekzekutiv ose këshillin drejtues të bankës për të kryer një zmadhim të mundshëm të kapitalit aksionar apo të instrumenteve të tjera të kapitalit aksionar të nivelit të parë, për një vlerë maksimale të përcaktuar, me qëllim që në rast se Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron kompetencat e parashikuara në nenin 47, të këtij ligji, banka të mos ketë pengesa për të emetuar në çdo kohë aksione të reja ose instrumente të tjera të pronësisë.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson nëse është e përshtatshme të vendosë detyrimin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, për një bankë të veçantë, në funksion të hartimit apo përditësimit të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për atë bankë ose grup bankar.

3. Nëse plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon përdorimin e mundshëm të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme verifikon nëse kapitali aksionar që autorizohet ose instrumentet e tjera të kapitalit të zakonshëm të nivelit të parë janë të mjaftueshme për të mbuluar shumën e vlerave të përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 4, të nenit 34, të këtij ligji.

4. Në rast të rritjes së kapitalit nëpërmjet konvertimit të detyrimeve në aksione, nuk mund të ushtrohen të drejtat e parablerjes së aksionarëve dhe nuk nevojitet miratimi i aksionarëve.

Neni 42
Njohja kontraktuale e rikapitalizimit nga brenda

1. Bankat parashikojnë dispozita kontraktore, me anë të të cilave kreditorët apo palët në kontrata që krijojnë detyrime, njohin dhe pranojnë se ky detyrim mund t'u nënshtrohet kompetencave të zhvlerësimit e të konvertimit dhe bien dakord që të

pranojnë çdo zvogëlim të kryegjësë apo të shumës së disbursuar e të papaguar, çdo konvertim apo anulim që kryhet nëpërmjet ushtrimit të këtyre kompetencave nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Dispozitat kontraktore, të përcaktuara sipas pikës 1, të këtij neni, zbatohen për të gjitha detyrimet që:

a) nuk janë përjashtuar sipas pikës 2, të nenit 31, të këtij ligji;

b) nuk janë depozita të siguruara;

c) rregullohen nga ligji i një vendi tjetër; dhe

ç) kanë lindur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk do të zbatohen në rast se detyrimet apo instrumentet e sipërpërmendura mund t'u nënshtrohen kompetencave të zhvlerësimit e të konvertimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme të vendit tjetër, në përputhje me ligjin që rregullon këto detyrime ose në përputhje me një marrëveshje të nënshkruar me autoritetet e këtij vendi.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund t'i kërkojë bankës të paraqesë një opinion të lëshuar nga një studio ligjore e njohur ndërkombëtarisht dhe të pranueshëm nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në lidhje me zbatueshmërinë e këtyre dispozitave në vendin e huaj përkatës.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, edhe në rastet kur banka nuk plotëson kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e zhvlerësimit e të konvertimit në lidhje me një detyrim të caktuar.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë të përcaktojë me akt nënligjor listën e detyrimeve, për të cilat zbatohet përjashtimi i pikës 2, të këtij neni, si dhe përmbajtjen e dispozitave kontraktore respektive.

Neni 43

Mbështetja financiare publike e jashtëzakonshme

1. Këshilli i Ministrave, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, në kushtet e nevojës dhe urgjencës, mund të sigurojë mbështetje financiare publike të jashtëzakonshme nëpërmjet instrumenteve publike të stabilizimit financiar, në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor, bashkëpunon me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për të ushtruar kompetencat e parashikuara në këtë nen dhe në nenin 44, të këtij ligji, me qëllim zbatimin e instrumenteve publike të stabilizimit financiar.

3. Instrumentet publike të stabilizimit financiar mund të përdoren si masë e fundit, vetëm pasi janë vlerësuar dhe/ose shfrytëzuar instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, përfshirë kërkesat e instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, të përcaktuar në pikën 6, të nenit 31, të këtij ligji.

Përdorimi i instrumenteve publike të stabilizimit financiar duhet të sigurojë stabilitetin e sistemit financiar dhe qëndrueshmërinë e financave publike në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë.

4. Këshilli i Ministrave, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, pas përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, bazuar në vlerësimin e situatës financiare dhe të masave të marra, të paraqitura nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, si dhe në rekomandimin e kësaj të fundit, mund të vendosë për zbatimin e instrumenteve publike të stabilizimit financiar, vetëm pasi janë plotësuar kushtet e parashikuara në pikën 1, të nenit 21, të këtij ligji, si edhe një prej kushteve të mëposhtme:

a) përdorimi i instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk është i mjaftueshëm për të shmangur një pasojë negative të konsiderueshme për sistemin financiar;

b) përdorimi i instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk është i mjaftueshëm për të mbrojtur interesin publik, kur bankës i është dhënë më parë kredi për mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë.

5. Instrumentet publike të stabilizimit financiar janë:

a) pjesëmarrja me fonde publike në kapitalin e bankës, sipas pikës 1, të nenit 44, të këtij ligji;

b) transferimi i përkohshëm i pronësisë së aksioneve të bankës te një subjekt publik, sipas pikës 2, të nenit 44, të këtij ligji, i cili zbatohet vetëm kur bankës i është dhënë më parë mbështetje nëpërmjet instrumentit publik të stabilizimit financiar, të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të këtij neni.

Neni 44
Instrumentet publike të stabilizimit financiar

1. Ministria e Financave, si përfaqësuese e Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin tregtar, mund të marrë pjesë në rikapitalizimin e një banke, duke dhënë fonde publike, në përputhje me parashikimet e nenit 43, të këtij ligji, në këmbim:

a) të instrumenteve të kapitalit aksionar të nivelit të parë;

b) të instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë ose instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë.

2. Ministria e Financave mund të transferojë përkohësisht pronësinë e këtyre aksioneve të bankës me anë të instrumentit të transferimit të përkohshëm të aksioneve te një subjekt publik.

3. Ministria e Financave siguron që subjekti, në të cilin zotëron instrumentet e kapitalit, të administrohet në mënyrë profesionale e të kujdesshme, si dhe instrumentet e kapitalit t'i transferohen më pas një subjekti të sektorit privat sa më shpejt që ta lejojnë kushtet tregtare e financiare.

KREU VI
KOMPETENCA E ZHVLERËSIMIT DHE KONVERTIMIT

SEKSIONI 1
ZHVLERËSIMI DHE KONVERTIMI I INSTRUMENTEVE TË KAPITALIT

Neni 45
Kërkesa për të zhvlerësuar ose konvertuar instrumentet e kapitalit

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur veprimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme rezulton me humbje, të cilat përballohen nga kreditorët ose nëpërmjet konvertimit të pretendimeve të tyre, ushtron kompetencat e zhvlerësimit e të konvertimit të instrumenteve të kapitalit, në përputhje me këtë nen përpara ose njëkohësisht me aplikimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Kompetencat e zhvlerësimit e të konvertimit të instrumenteve të kapitalit mund të ushtrohen:

a) në mënyrë të pavarur nga veprimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme; ose

b) në kombinim me një nga instrumentet ose masat e tjera të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron kompetencat e zhvlerësimit e të konvertimit të instrumenteve të kapitalit, të emetuara nga një bankë, kur ekzistojnë një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme:

a) janë përmbushur kushtet për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji;

b) banka ose grupi bankar nuk do të jetë më rentabël nëse nuk ushtrohet kjo kompetencë në lidhje me instrumentet përkatëse të kapitalit;

c) është e nevojshme mbështetja financiare publike e jashtëzakonshme për bankën, me përjashtim të rrethanave të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 3, të nenit 21, të këtij ligji.

4. Për qëllime të pikës 3, të këtij neni, një bankë vlerësohet se nuk është më rentabël vetëm në qoftë se përmbushen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) banka ose grupi bankar konsiderohet të jetë pranë një situate të pashmangshme paaftësie paguese;

b) nuk ka asnjë perspektivë të arsyeshme se ndonjë veprim, përfshirë masat alternative të sektorit privat ose veprim mbikëqyrës, pa përfshirë zhvlerësimin ose konvertimin e instrumenteve të kapitalit, në mënyrë të pavarur ose në kombinim me një veprim të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, mund të parandalonte mospërmbushjen e detyrimeve nga ana e bankës ose grupit bankar, sipas shkronjës "a", të kësaj pike, brenda një afati kohor të arsyeshëm.

5. Për qëllimet e shkronjës "a", të pikës 4, të këtij neni, një bankë konsiderohet të jetë pranë një situate të pashmangshme paaftësie paguese, nëse ekzistojnë një ose më shumë nga rrethanat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 21, të këtij ligji.

6. Për qëllimet e shkronjës "a", të pikës 4, të këtij neni, një grup konsiderohet të jetë pranë një situate të pashmangshme paaftësie paguese nëse grupi i shkel ose ka elemente objektive për të mbështetur një konstatim se grupi, në të ardhmen e afërt, do t'i shkelë kërkesat e mbikëqyrjes së konsoliduar në atë mënyrë që të justifikojë veprimin e autoritetit kompetent, përfshirë, ndër të tjera, për shkak të faktit se grupit i kanë lindur ose ka të ngjarë t'i lindin humbje që do të shteronin të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të kapitalit rregullator.

7. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, përpara ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit e të konvertimit të instrumenteve të kapitalit, sigurohet që të bëhet vlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve të bankës, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji. Ky vlerësim përbën bazën e llogaritjes së zhvlerësimit që u bëhet instrumenteve përkatëse të kapitalit, në mënyrë që të përthithen humbjet, si dhe për nivelin e konvertimit që u bëhet instrumenteve përkatëse të kapitalit, në mënyrë që të rikapitalizohet banka.

8. Çdo person fizik ose juridik, i cili pretendon se të drejtat apo interesat e ligjshëm të tij janë cenuar nga masat e mësipërme, ka të drejtë të kryejë ankim, në përputhje me nenet 84 dhe 85, të këtij ligji, në rast se kompetencat e zhvlerësimit e të konvertimit të instrumenteve të kapitalit ushtrohen, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni.

Neni 46

Parashikimet për zhvlerësimin ose konvertimin e instrumenteve të kapitalit

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron kompetencat e zhvlerësimit ose konvertimit të instrumenteve të kapitalit, në përputhje me radhën e shlyerjes së detyrimeve, sipas procedurës së likuidimit të detyruar, në mënyrë që të jepet rezultati i mëposhtëm:

a) fillimisht zvogëlohen zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë në përpjesëtim me humbjet dhe kapacitetin e tyre dhe Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ndërmerr një ose të dyja veprimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 34, të këtij ligji, në lidhje me mbajtësit e instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë;

b) zhvlerësohet ose konvertohet, ose të dyja veprimet bashkë, vlera e principalit të instrumenteve të kapitalit shtesë të nivelit të parë në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë, me aq sa është e nevojshme për të arritur objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të parashikuar në nenin 20, të këtij ligji, ose sa kapaciteti i instrumenteve përkatëse të kapitalit, cilido që të jetë më i ulëti;

c) zhvlerësohet ose konvertohet vlera e principalit të instrumenteve të kapitalit të nivelit të dytë në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë me aq sa është e nevojshme për të arritur objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të parashikuar në nenin 20, të këtij ligji ose sa kapaciteti i instrumenteve përkatëse të kapitalit, cilido që të jetë më i ulëti.

2. Kur zhvlerësohet principali i një instrumenti përkatës të kapitalit:

a) zvogëlimi i principalit është përfundimtar, në varësi të rivlerësimeve të bëra, në përputhje me mekanizmin e rimbursimit, të parashikuar në pikën 3, të nenit 33, të këtij ligji;

b) zotëruesi i instrumentit përkatës të kapitalit që është zhvlerësuar nuk gëzon më asnjë të drejtë lidhur me shumën e zhvlerësuar të instrumentit, me përjashtim të detyrimeve të papaguara, si dhe të të drejtave për dëmshpërblimet që mund të lindin si pasojë e një ankese që kundërshton ligjshmërinë e ushtrimit të kompetencës së zhvlerësimit;

c) asnjë kompensim nuk i paguhet zotëruesve të instrumenteve përkatëse të kapitalit, me përjashtim të parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

Shkronja "b" e kësaj pike nuk e pengon ushtrimin e të drejtave të zotëruesit të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për të kryer konvertimin e instrumenteve përkatëse të kapitalit, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, mund t'u kërkojë bankave të emetojnë instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë për zotëruesit e instrumenteve përkatëse të kapitalit. Instrumentet përkatëse të kapitalit mund të konvertohen vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) këto instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë janë emetuar nga banka ose nga banka mëmë, me pëlqimin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ose, sipas rastit, të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme të bankës mëmë;

b) këto instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë janë emetuar përpara çdo emetimi aksionesh ose instrumentesh të tjera pronësie nga kjo bankë, me qëllim sigurimin e kapitalit (rregullator) me mbështetje financiare publike të jashtëzakonshme ose nga një subjekt tjetër publik;

c) këto instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë jepen dhe transferohen pa vonesë pas ushtrimit të kompetencës së konvertimit;

ç) norma e konvertimit që përcakton numrin e instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë, që jepen në lidhje me secilin instrument përkatës të kapitalit, respekton parimet e parashikuara në nenin 37 të këtij ligji.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për qëllime të ofrimit të instrumenteve të kapitalit bazë të nivelit të parë, në përputhje me pikën 3, të këtij neni, mund t'u kërkojë bankave të mbajnë në çdo kohë autorizimin paraprak të nevojshëm për të emetuar numrin përkatës të instrumenteve të kapitalit të zakonshëm të nivelit të parë.

5. Kur një bankë i përmbush kushtet për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos të përdorë një instrument të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për këtë bankë, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton kërkesën e parashikuar në pikën 3, të nenit 45, të këtij ligji, përpara përdorimit të instrumentit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

SEKSIONI 2
KOMPETENCAT E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 47
Kompetencat e përgjithshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron ndaj bankës, e cila plotëson kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme, një ose disa prej kompetencave të mëposhtme:

a) t'i kërkojë çdo personi që t'i japë informacionin e kërkuar për të vendosur dhe për të përgatitur veprimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë përditësime dhe informacione shtesë nga ato të dhëna në planet për ndërhyrje të jashtëzakonshme, si dhe informacionet që jepen gjatë inspektimit në vend;

b) të zbatojë instrumentet dhe kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

c) të marrë nën kontroll bankën, duke ushtruar të gjitha të drejtat dhe kompetencat e aksionarëve dhe të organeve të administrimit;

ç) të transferojë aksionet ose instrumente të tjera të pronësisë, të emetuara nga banka;

d) të transferojë të drejta, aktive ose detyrime të bankës te një subjekt tjetër, me miratimin e këtij të fundit;

dh) të zvogëlojë pjesërisht apo tërësisht detyrimet ose shumën e lëvruar dhe të papaguar të detyrimeve të pranuara të bankës;

e) të konvertojë detyrimet e pranuara të bankës në aksione të zakonshme ose instrumente të tjera të kapitalit të bankës, të bankës mëmë ose të bankës urë, të cilave u janë transferuar aktivet, të drejtat ose detyrimet e kësaj banke;

ë) të anulojë titujt e borxhit të emetuar nga banka, me përjashtim të detyrimeve të siguruara, të parashikuara në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji;

f) të ndryshojë datën e maturimit të titujve të borxhit të emetuar nga banka apo të detyrimeve të tjera të pranuara ose normën e interesit, të pagueshme mbi këto tituj dhe detyrime të tjera të pranuara ose datën në të cilën interesi bëhet i pagueshëm dhe të pezullojë pagesën për një kohë të caktuar, me përjashtim të pagesave që rrjedhin nga detyrimet e siguruara, të parashikuara nga pika 2, e nenit 31, të këtij ligji;

g) të përfundojë dhe të kompensojë kontratat financiare ose kontratat mbi produktet derivative, me qëllim zbatimin e nenit 36 të këtij ligji;

gj) të shkarkojë ose të zëvendësojë anëtarët e organeve të administrimit të bankës;

h) të zvogëlojë vlerën nominale të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë të bankës ose t'i anulojë ato;

i) t'i kërkojë bankës ose bankës mëmë që të emetojë aksione të reja, duke përfshirë aksione me të drejtë preference apo obligacione të konvertueshme në aksione.

2. Zbatimi i instrumenteve apo ushtrimi i kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga ana e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nuk i nënshtrohet asnjë miratimi nga ndonjë person apo autoritet, duke përfshirë autoritetet publike, aksionarët ose kreditorët e bankës që është vendosur në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe asnjë kërkesë për të publikuar ndonjë njoftim apo prospekt apo për të depozituar ndonjë dokument përpara ndonjë autoriteti, përveç rasteve kur parashikohet në këtë ligj.

3. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron kompetencat sipas pikës 1, të këtij neni, garancitë e parashikuara në nenet 56 - 63 të këtij ligji zbatohen për personat, të drejtat e të cilëve janë prekur, përfshirë aksionarët, kreditorët dhe palët e treta.

Neni 48
Kompetencat shtesë

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë ushtrimit të kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ka të drejtë të ushtrojë kompetencat shtesë të mëposhtme:

a) nga çdo e drejtë apo barrë/peng/hipotekë që prek instrumentet financiare të përcaktojë se një transferim mund të jetë i lirë për të drejtat, aktivet ose detyrimet që transferohen në zbatim të nenit 61 të këtij ligji. Çdo e drejtë për kompensim, sipas parashikimeve të këtij ligji, nuk konsiderohet se është një detyrim apo barrë/peng/hipotekë;

b) t'i ndalojë bankës të drejtën për të zotëruar aksione të tjera ose instrumente të tjera të pronësisë;

c) t'i kërkojë autoritetit përkatës të ndërpresë apo të pezullojë pranimin për tregtim në një treg të rregulluar apo listimin në bursë të instrumenteve financiare të emetuara nga banka;

ç) të përcaktojë që marrësi të trajtohet sikur të ishte objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme në lidhje me çdo të drejtë, detyrim ose veprim të marrë sipas neneve 26 dhe 28, të këtij ligji, duke përfshirë çdo të drejtë ose detyrim në lidhje me pjesëmarrjen në treg të rregulluar;

d) t'i kërkojë bankës ose marrësit t'i japin njëri-tjetrit informacione dhe ndihmën e nevojshme;

dh) të mos zbatojë ose të ndryshojë kushtet e kontratave, në të cilat banka është palë ose të sigurohet që marrësi merr vendin e tij si palë.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me qëllim vazhdimin e aktivitetit tregtar të transferuar nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme te një subjekt tjetër, ka të drejtë të sigurojë marrësin për:

a) vijueshmërinë e kontratave të nënshkruara nga banka, në mënyrë që marrësi të marrë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me çdo instrument financiar, të drejtë, aktiv ose detyrim dhe të zëvendësojë këtë bankë shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar si palë në të gjitha kontratat përkatëse; dhe

b) zëvendësimin e bankës në çdo procedurë ligjore në lidhje me çdo instrument financiar, të drejtë, aktiv ose detyrim që është transferuar pavarësisht nga miratimi i palës tjetër.

3. Kompetencat e parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, dhe shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, nuk do të cenojnë:

a) të drejtën e punëmarrësit të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme për të përfunduar kontratën e punës;

b) të drejtën e një pale në një kontratë të ushtrojë të drejtat sipas kontratës, duke përfshirë të drejtën për të përfunduar kontratën, kur e fiton këtë të drejtë në përputhje me kushtet e kontratës për shkak të veprimit apo mosveprimit të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme përpara kryerjes së transferimit apo nga marrësi pas këtij transferimi.

Neni 49

Kompetenca për të kërkuar ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e infrastrukturës

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka kompetencën t'i kërkojë bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të ofrojë çdo shërbim apo të sigurojë infrastrukturën e nevojshme për të mundësuar që marrësi të ushtrojë në mënyrë efektive aktivitetin tregtar që i është transferuar.

2. Përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, zbatohet edhe nëse ndaj bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ka filluar procedura e likuidimit të detyruar.

3. Ofrimi i shërbimeve operacionale dhe lehtësi, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk përfshin asnjë formë mbështetjeje financiare.

4. Shërbimet dhe lehtësitë e përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, ofrohen:

a) sipas kushteve të marrëveshjeve përkatëse për ofrimin e shërbimeve dhe lehtësive në fuqi përpara se veprimi për ndërhyrje të jashtëzakonshme të ndërmerret dhe për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes; ose

b) nëse nuk ka një marrëveshje të tillë ose nëse marrëveshjes i ka mbaruar afati, sipas kushteve të arsyeshme.

Neni 50

Kompetenca në lidhje me aktivet, të drejtat, detyrimet dhe aksionet e ndodhura në vende të tjera

1. Në rast se ndërhyrja e jashtëzakonshme përfshin veprime në lidhje me aktive të ndodhura në një vend tjetër ose instrumente pronësie, të drejta ose detyrime që i nënshtrohen ligjit të një shteti tjetër, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme kërkon që:

a) administratori ose marrësi të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që transferimi, zhvlerësimi, konvertimi ose veprimi të bëhen efektive;

b) administratori ose marrësi të mbajë aksionet ose instrumente të tjera kapitali, aktivet ose të drejtat, ose të shuajë detyrimet për llogari të

marrësit derisa transferimi, zhvlerësimi, konvertimi ose veprimi të bëhet efektiv;

c) shpenzimet e arsyeshme të marrësit për kryerjen e veprimeve të përmendura në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni, përballohen sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 25, të këtij ligji.

2. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vlerëson se, pavarësisht nga ndërmarrja e të gjitha masave të përmendura në pikën 1, të këtij neni, nga administratori ose marrësi ka pak mundësi që ushtrimi i kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit të jetë efektiv për aktivet që ndodhen në një shtet tjetër ose për aksione, instrumente të tjera të pronësisë, të drejta apo detyrime të rregulluara nga ligji i një vendi tjetër, atëherë nuk kërkon transferimin, zhvlerësimin ose konvertimin. Nëse ky veprim është bërë, ky urdhër anulohet dhe konsiderohet i pavlefshëm.

Neni 51

Përjashtimi i kushteve kontraktuale të caktuara në ndërhyrjen e hershme dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme

1. Zbatimi i masave të parashikuara në këtë ligj, duke përfshirë edhe ndodhjen e një ngjarjeje të lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e këtyre masave, nuk konsiderohet si një rast mospërmbushjeje ose kusht për fillimin e likuidimit të detyruar, në bazë të së cilave mund të ekzekutohet marrëveshja e kolateralit financiar, me kusht që të vazhdojnë të përmbushen detyrimet thelbësore të kontratës.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për kontrata të nënshkruara nga:

a) një shoqëri e kontrolluar e bankës, detyrimet e së cilës garantohen nga banka apo një subjekt tjetër i grupit bankar;

b) një subjekt i grupit, të cilit banka i përket dhe që përmban dispozita për mospërmbushje të ndërsjella.

3. Në rast se detyrimet thelbësore të kontratës, përfshirë pagimin dhe përmbushjen e detyrimeve dhe vënien në dispozicion të kolateralit, vijojnë të përmbushen, masat e marra, sipas këtij ligji, përfshirë ndodhjen e një ngjarjeje të lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e këtyre masave, nuk përbën shkak që palët kontraktore:

a) të ushtrojnë të drejta zgjidhjeje, pezullimi, modifikimi, kompensimi *set-off* ose kompensimi *netting* në lidhje me një kontratë të lidhur nga:

i) një filial, kur detyrimet e lindura nga kjo kontratë garantohen nga një subjekt i grupit;

ii) cilido subjekt i grupit, kur përfshihen klauzola për mospërmbushjen e ndërsjellë të kontratës;

b) të marrin në zotërim, të ushtrojnë kontroll ose të ekzekutojnë çdo garanci të vendosur mbi pronat e bankës në fjalë ose të çdo subjekti të grupit, në lidhje me një kontratë që përfshin klauzolën për mospërmbushjen e ndërsjellë të kontratës;

c) të cenojnë të drejtat kontraktore të bankës në fjalë ose të çdo subjekti të grupit, në lidhje me një kontratë që përfshin klauzolën për mospërmbushjen e ndërsjellë të kontratës.

Neni 52

Kompetenca për të pezulluar detyrime të caktuara

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e pagesave dhe shlyerjen e detyrimeve, të cilat lindin nga një kontratë në të cilën banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme është palë dhe ta publikojë atë urdhër, sipas parashikimeve të nenit 66 të këtij ligji. Ky pezullim ka efekt për të dyja palët kontraktore.

2. Autoriteti përcakton në urdhër ditën dhe orën kur pezullimi hyn në fuqi dhe e publikon atë sipas nenit 66 të këtij ligji.

3. Pezullimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, zbatohet duke filluar nga momenti i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, dhe zgjat deri në mesnatën e ditës pasuese të punës, duke filluar nga dita e specifikuar në vendim.

4. Kur një pagesë apo detyrim bëhet i kërkueshëm gjatë periudhës së pezullimit, pagesa ose shlyerja bëhet menjëherë pas mbarimit të periudhës së pezullimit.

5. Si përjashtim nga parashikimet e pikës 1, të këtij neni, vendimi për pezullim nuk zbatohet për:

a) depozitat e siguruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave;

b) pagesën dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj sistemeve dhe operatorëve të sistemeve të pagesave të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme duhet të marrë në konsideratë ndikimin që mund të ketë ushtrimi i kompetencës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, në funksionimin e tregut financiar.

Neni 53
Kompetenca për të pezulluar përkohësisht ekzekutimin e mjeteve që sigurojnë ekzekutimin e detyrimeve

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit nga kreditorët mbi pasuritë e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të cilat shërbejnë si mjete që sigurojnë ekzekutimin e detyrimeve. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme e publikon menjëherë këtë urdhër, sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 66, të këtij ligji, duke specifikuar ditën dhe orën kur pezullimi hyn në fuqi. Pezullimi i ekzekutimit zgjat deri në mesnatën e ditës pasuese të punës, duke filluar nga data e publikimit të urdhrit, sipas nenit 66 të këtij ligji.

2. Si përjashtim nga pika 1, e këtij neni, urdhri për pezullim nuk zbatohet për pasuritë e bankës, të dhëna si kolateral në sistemet dhe operatorët e sistemeve të rregulluara nga legjislacionit në fuqi për sistemin e pagesave.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme duhet të marrë në konsideratë ndikimin që mund të ketë ushtrimi i kompetencës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, mbi funksionimin e tregut financiar.

Neni 54
Kompetenca për të pezulluar përkohësisht të drejtat për zgjidhjen e kontratës

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e përkohshëm të së drejtës për zgjidhjen e kontratës nga palë të treta, të cilat mund të kenë marrëdhënie kontraktore me bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme, me kusht që detyrimet kontraktore dhe ofrimi i garancive ose kolateralit të vazhdojnë të përmbushen. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme publikon menjëherë këtë urdhër, sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 66, të këtij ligji, duke specifikuar ditën dhe orën kur pezullimi hyn në fuqi.

2. Kompetenca e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të përfshijë marrëdhënie kontraktore midis një pale të tretë dhe shoqërisë së kontrolluar nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme në këto raste:

a) nëse detyrimet kontraktore janë garantuar apo mbështeten në çfarëdo formë nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

b) nëse e drejta për të zgjidhur kontratën bazohet vetëm në gjendjen financiare apo likuidimin e detyruar të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme; dhe

c) në rast të ushtrimit të kompetencave të transferimit të përcaktuar në këtë ligj në lidhje me bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të gjitha aktivet dhe detyrimet e shoqërisë së kontrolluar që lidhen me atë kontratë janë ose transferohen te marrësi, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme garanton në çfarëdo mënyrë këto detyrime.

3. Si përjashtim nga pikat e mësipërme, vendimi për pezullim nuk zbatohet për sistemet e pagesave dhe operatorët e sistemeve të pagesave, të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi për sistemin e pagesave.

4. Si përjashtim nga pikat e mësipërme, një palë mund të zgjidhë një kontratë përpara përfundimit të periudhës së pezullimit nëse njoftohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme se të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata nuk i transferohen marrësit ose nuk zhvlerësohen apo konvertohen gjatë zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 30, të këtij ligji.

5. Pezullimi i ekzekutimit zgjat deri në mesnatën e ditës pasuese të punës duke filluar nga data e publikimit të urdhrit, sipas nenit 66 të këtij ligji.

Neni 55
Ushtrimi i kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ushtron kontroll mbi bankat në ndërhyrje të jashtëzakonshme, me qëllim që:

a) të drejtojë bankën me të gjitha kompetencat e aksionarëve dhe administratorëve të vet;

b) të administrojë dhe të disponojë aktivet e pronat e bankës.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ushtron kontrollin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet administratorit të posaçëm.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme sigurohet që të mos ushtrohen të drejtat e votës që

rrjedhin nga aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë së bankës që është në procesin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

SEKSIONI 3
MBROJTJA E AKSIONARËVE DHE KREDITORËVE

Neni 56
Trajtimi i aksionarëve dhe kreditorëve në rastet e transfertave të pjesshme dhe zbatimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda

1. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme transferon vetëm një pjesë të të drejtave, aktiveve dhe detyrimeve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e aksionarëve dhe kreditorëve, pretendimet e të cilëve nuk janë transferuar, ata përfitojnë të paktën sa mund të kishin marrë në qoftë se banka do t'i ishte nënshtruar likuidimit të detyruar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, në kohën kur është marrë vendimi i përmendur në nenin 65 të këtij ligji.

2. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton instrumentin e rikapitalizimit nga brenda, aksionarët dhe kreditorët, pretendimet e të cilëve janë zhvlerësuar ose konvertuar, nuk duhet të pësojnë humbje më të mëdha nga sa ata do të kishin pësuar në qoftë se banka do t'i ishte nënshtruar likuidimit të detyruar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, menjëherë në kohën kur është marrë vendimi i përmendur në nenin 65 të këtij ligji.

Neni 57
Vlerësimi i diferencës në mënyrën e trajtimit

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, menjëherë pas vendosjes së bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose menjëherë pas përdorimit të instrumenteve ose kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kryen një vlerësim të pavarur për të përcaktuar nëse aksionarët dhe kreditorët e bankës do të ishin në një pozitë më të favorshme në rast se do të kishte filluar procedura e likuidimit të detyruar në vend të procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Vlerësimi sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, përcakton:

a) efektin që do të ketë mbi aksionarët dhe kreditorët ose skemat përkatëse të sigurimit të depozitave, nëse banka nën procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për të cilën është kryer veprimi ose veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, do t'i ishte nënshtruar likuidimit të detyruar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, në kohën kur është marrë vendimi i përmendur në nenin 65 të këtij ligji;

b) efektin aktual që aksionarët dhe kreditorët kanë marrë në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, që i është nënshtruar kësaj procedure;

c) diferencën, nëse ka, ndërmjet vlerësimeve të kryera sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike.

3. Vlerësimi duhet:

a) të marrë parasysh se banka, e cila i është nënshtruar procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për të cilën është kryer veprimi ose veprimet, do t'i ishte nënshtruar likuidimit të detyruar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, në kohën kur është marrë vendimi i përmendur në nenin 65 të këtij ligji;

b) të marrë parasysh se veprimi ose veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk janë zbatuar;

c) të mos marrë parasysh çdo dispozitë për mbështetjen financiare publike të jashtëzakonshme të bankës, e cila i është nënshtruar procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të përcaktojë me akt nënligjor metodologjinë për kryerjen e vlerësimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 58
Mbrojtja e aksionarëve dhe kreditorëve

Çdo aksionar ose kreditor, i përmendur në nenin 56, të këtij ligji, ose skema e sigurimit të depozitave, në përputhje me nenin 78, që nga vlerësimi i kryer sipas nenit 57, të këtij ligji, rezulton se ka pësuar humbje më të mëdha nga sa do të kishte pësuar nëse banka do t'i ishte nënshtruar likuidimit të detyruar, sipas legjislacionit në fuqi për bankat në Republikën e Shqipërisë, gëzon të drejtën për përfitimin e diferencës nga "Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

Neni 59
Masat mbrojtëse për palët e tjera në transferimin e pjesshëm

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme siguron mbrojtjen e duhur për marrëveshjet e mëposhtme dhe palët e tyre:

a) marrëveshjet e garancisë;

b) marrëveshjet e kolateralit financiar për transferimin e titullit;

c) marrëveshjet e kompensimit (*set off)*

ç) marrëveshjet e kompensimit (*netting*);

d) obligacionet e siguruara;

dh) marrëveshjet e tjera financiare, që përfshijnë titullizimin dhe instrumentet për zbutjen e rrezikut, të cilat bëjnë pjesë në grupin e instrumenteve financiare të siguruara dhe garantohen në mënyrë të ngjashme me obligacionet e siguruara.

2. Masat mbrojtëse për marrëveshjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, zbatohen në rast se Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme:

a) transferon disa nga, por jo të gjitha aktivet, të drejtat ose detyrimet e një banke, e cila është vënë në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme te një subjekt tjetër apo nga një bankë urë apo shoqëri e administrimit të aktiveve te një subjekt tjetër;

b) ushtron kompetencat e përcaktuara në shkronjën "dh", të pikës 1, të nenit 48, të këtij ligji.

3. Masat mbrojtëse zbatohen pavarësisht nga numri i palëve të përfshira në marrëveshje.

4. Në kuptim të këtij neni dhe të nenit 61, të këtij ligji, me termin "marrëveshje garancie" do të kuptohet çdo marrëveshje pengu, hipoteke e barrë siguruese.

5. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të specifikojë me akt nënligjor llojet e marrëveshjeve, të cilat bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 60
Mbrojtja për marrëveshjet e kolateralit financiar për transferimin e titullit, marrëveshjet e kompensimit *set off* dhe *netting*

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të ndalojë transferimin e pjesshëm të të drejtave dhe detyrimeve që kanë lindur nga marrëveshjet e kolateralit financiar për transferimin e titullit, marrëveshjet repo, marrëveshjet e kompensimit *set off* dhe *netting*, ku është palë banka, e cila i nënshtrohet procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe mund të ndryshojë ose të ndërpresë të drejtat dhe detyrimet që kanë lindur nga këto marrëveshje përmes përdorimit të kompetencave shtesë, të parashikuara në nenin 48 të këtij ligji.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, të drejtat dhe detyrimet duhet të trajtohen si të mbrojtura në bazë të një marrëveshjeje të tillë, nëse palët në marrëveshje kanë të drejtë të kompensojnë këto të drejta dhe detyrime.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, kur është e nevojshme për të siguruar disponueshmërinë e depozitave të siguruara, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund që:

a) të transferojë depozitat e siguruara që janë pjesë e ndonjë prej marrëveshjeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, pa transferuar aktive, të drejta ose detyrime të tjera që janë pjesë e së njëjtës marrëveshje; dhe

b) të transferojë, të modifikojë ose të ndërpresë ato aktive, të drejta ose detyrime pa transferuar depozitat e sigurueshme.

Neni 61
Mbrojtja për marrëveshjet e garancisë

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për detyrimet e siguruara me anë të një marrëveshjeje garancie mund të vendosë transferimin njëkohësisht të detyrimit dhe garancisë.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, kur është e nevojshme për të siguruar disponueshmërinë e depozitave të sigurueshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund:

a) të transferojë depozitat e sigurueshme që janë pjesë e ndonjë prej marrëveshjeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, pa transferuar aktivet, të drejtat ose detyrimet e tjera që janë pjesë e së njëjtës marrëveshje; dhe

b) të transferojë, të modifikojë ose të ndërpresë ato aktive, të drejta ose detyrime pa transferuar depozitat e sigurueshme.

Neni 62
Mbrojtja për marrëveshjet e tjera financiare dhe obligacionet e siguruara

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për marrëveshjet e tjera financiare, përfshirë

marrëveshjet e përfshira në shkronjat "d" dhe "dh", të pikës 1, të nenit 59, të këtij ligji, mund të vendosë:

a) të ndalojë transferimin e pjesshëm të aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga marrëveshje të tjera financiare, ku është palë banka, e cila i nënshtrohet procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

b) të ndërpresë ose të ndryshojë, përmes përdorimit të kompetencave shtesë, të parashikuara në nenin 48, të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet që përbëjnë ose janë pjesë e marrëveshjeve të tjera financiare, ku është palë banka, e cila i nënshtrohet procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, kur është e nevojshme për të siguruar disponueshmërinë e depozitave të siguruara, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë:

a) të transferojë depozitat e siguruara që janë pjesë e ndonjë prej marrëveshjeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, pa transferuar aktivet, të drejtat ose detyrimet e tjera që janë pjesë e së njëjtës marrëveshje; dhe

b) të transferojë, të modifikojë ose të ndërpresë ato aktive, të drejta ose detyrime pa transferuar depozitat e siguruara.

Neni 63

Transferimi i pjesshëm, mbrojtja e sistemeve të pagesave dhe sistemeve të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme siguron që zbatimi i një prej instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të mos ndikojë ose të mos cenojë funksionimin e sistemeve të pagesave dhe sistemeve të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve, në rastet kur:

a) transferon pjesërisht të drejtat ose detyrimet e një banke nën ndërhyrjen e jashtëzakonshme te një subjekt tjetër; ose

b) përdor kompetencat shtesë, të parashikuara në nenin 48, të këtij ligji, për të anuluar apo ndryshuar kushtet e kontratës, në të cilën banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme është palë ose të zëvendësojë një marrës si palë.

2. Transferimi, anulimi ose ndryshimi i referuar në pikën 1, të këtij neni, nuk revokon urdhrin e transferimit në kundërshtim me legjislacionit në fuqi për sistemin e pagesave dhe nuk modifikon ose mohon zbatueshmërinë e urdhrave të transferimit dhe kompensimin e përdorimit të fondeve, titujve apo kreditit ose mbrojtjen e kolateralit, siç kërkohet nga i njëjti ligj.

KREU VII

VEPRIMET PROCEDURALE

Neni 64

Kërkesat për njoftimet

1. Këshilli drejtues i bankës është i detyruar të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës kur konstaton se banka është pranë një situate të pashmangshme paaftësie paguese, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 24, të këtij ligji.

2. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme konstaton se për një bankë janë plotësuar kushtet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, ai e komunikon këtë konstatim pa vonesë dhe duke i kushtuar kujdesin e nevojshëm ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit te:

a) Ministria e Financave;

b) Komisioni i Ndihmës Shtetërore;

c) Autoriteti Mbikëqyrës dhe Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme i çdo dege të kësaj banke jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ç) Agjencia e Sigurimit të Depozitave;

d) kur është e zbatueshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në nivel grupi bankar;

dh) Autoriteti Mbikëqyrës, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e konsoliduar në nivel grupi bankar kur subjekti i nënshtrohet mbikëqyrjes mbi baza të konsoliduara.

Neni 65

Vendimi për ndërhyrje të jashtëzakonshme

Vendimi i Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme përmban:

a) arsyet për marrjen e vendimit, duke deklaruar faktin që banka plotëson kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme;

b) veprimet konkrete që do të zbatohen, duke përfshirë, por pa u kufizuar në instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kompetencën e zhvlerësimit e të konvertimit, emërimin e një administratori të posaçëm.

Neni 66
Detyrimet procedurale të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

1. Menjëherë pas marrjes së vendimit për ndërhyrje të jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme njofton bankën përkatëse dhe autoritetet e referuara në pikën 2, të nenit 64, të këtij ligji.

2. Njoftimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, përfshin një kopje të çdo akti administrativ, nëpërmjet të cilit janë ushtruar kompetencat përkatëse dhe tregon datën nga e cila bëhen efektive veprimi ose veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme publikon një kopje të vendimit për ndërhyrje të jashtëzakonshme ose një njoftim, i cili përmbledh efektet e veprimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe, në veçanti, efektet mbi depozituesit e siguruar.

4. Publikimi bëhet:

a) në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë;

b) në faqen e internetit të bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

c) në tregun e rregulluar ku janë pranuar për tregtim aksionet, instrumentet e tjera të pronësisë apo të borxhit, të bankës, objekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

ç) Buletinin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 67
Konfidencialiteti

1. Çdo informacion, i cili lidhet me zbatimin e dispozitave të këtij ligji përbën sekret profesional. Kërkesat e sekretit profesional janë të detyrueshme për të gjithë individët dhe personat juridikë, të cilët njihen me informacionin sekret profesional gjatë zbatimit të këtij ligji dhe veçanërisht për subjektet dhe personat e mëposhtëm:

a) Banka e Shqipërisë;

b) Ministria e Financave;

c) Komisioni i Ndihmës Shtetërore;

ç)administratorët e posaçëm apo administratorët e përkohshëm, të emëruar sipas këtij ligji;

d) blerësit e mundshëm të kontaktuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, pavarësisht nëse kontakti apo kërkesa është bërë si përgatitje për përdorimin e instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar, dhe pavarësisht nëse kërkesa rezulton ose jo në një blerje;

dh) auditorët, kontabilistët, këshilltarët ligjorë dhe profesionalë, vlerësuesit dhe ekspertët e tjerë të angazhuar direkt ose indirekt nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Ministria e Financave ose nga blerës të mundshëm, të përmendur në shkronjën "ç", të kësaj pike;

e) Agjencia e Sigurimit të Depozitave;

ë) organi përgjegjës për marrëveshjet e financimit, sipas ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

f) banka urë apo shoqëria për administrimin e aktiveve;

g) çdo person tjetër që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ofron ose ka ofruar shërbime për personat e përmendur në shkronjën 1 të këtij neni;

gj) administratorët, anëtarët e organit të administrimit dhe punonjësit e organeve apo të subjekteve të referuara në shkronjat "a" deri në "f" para, gjatë dhe pas emërimit të tyre.

2. Subjektet dhe personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ndalohen t'i japin çdo personi apo autoriteti informacionin konfidencial të marrë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre profesionale ose të marrë nga çdo autoritet apo Banka e Shqipërisë në lidhje me funksionet e përcaktuara në këtë ligj, përveç nëse:

a) dhënia e informacionit lidhet me ushtrimin e funksioneve të tyre, sipas këtij ligji; ose

b) informacioni jepet në mënyrë të përmbledhur ose formë kolektive, me qëllim që bankat individuale të mos identifikohen; ose

c) me pëlqimin paraprak të shprehur të bankës, e cila ka dhënë informacionin.

3. Çdo person apo subjekt i referuar në pikën 1, të këtij neni, i nënshtrohet përgjegjësisë civile dhe penale në rast të shkeljes së këtij neni, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

4. Ky nen nuk i pengon:

a) punonjësit dhe ekspertët e organeve apo subjekteve të referuara në pikën 1, të këtij neni, të shkëmbejnë informacionin ndërmjet tyre brenda secilit organ ose subjekt;

b) Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë punonjësit dhe ekspertët e saj, të shkëmbejë informacionin me autoritete të tjera, ministritë kompetente, bankat qendrore, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, autoritetet përgjegjëse për procedurat e likuidimit të detyruar, autoritetet përgjegjëse për ruajtjen e stabilitetit të sistemit

financiar përmes përdorimit të politikave makroprudenciale, personat e ngarkuar me kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive ose autoritetet e vendeve të tjera që kryejnë funksione të barasvlershme me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me të cilat kanë lidhur marrëveshje, sipas nenit 70, të këtij ligji, ose një blerësi të mundshëm, për qëllime të planifikimit ose kryerjes së një veprimi të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke zbatuar kërkesa të rrepta të konfidencialitetit.

5. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikat e mësipërme të këtij neni, subjektet dhe personat e përmendur në pikën 1, të tij, mund t'ia bëjnë të ditur informacionin e përfituar gjatë zbatimit të këtij ligji në rastet e mëposhtme:

a) çdo personi tjetër, kur është e nevojshme për qëllime të planifikimit ose kryerjes së një veprimi të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke zbatuar kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit;

b) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare dhe të shoqërive të sigurimit, si dhe personave të ngarkuar me kryerjen e auditimeve ligjore;

c) autoriteteve përkatëse, në zbatim të procedurave ligjore në çështjet penale apo civile.

6. Dhënia e informacionit të përfituar nga autoritetet mbikëqyrëse apo të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të shteteve të tjera subjekteve të parashikuara në pikën 5, të këtij neni, bëhet vetëm pas dhënies së miratimit paraprak të autoritetit, i cili ka dhënë informacionin.

7. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton rregullat e brendshme mbi sekretin profesional dhe shkëmbimin e informacioneve midis njësive organizative, të cilat përgjigjen për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe funksionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

KREU VIII
E DREJTA E ANKIMIT DHE PËRJASHTIMI I AKTIVITETEVE TË TJERA

Neni 68
E drejta e ankimit

1. Çdo person fizik ose juridik, të drejtat apo interesat e ligjshëm të të cilit janë cenuar nga vendimi për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe vendimi për emërimin e administratorit të posaçëm, të përcaktuar në nenin 23, të këtij ligji, ka të drejtë të kryejë ankim administrativ te Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, brenda 30 ditëve nga data e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Njoftimi publikohet edhe në dy televizione kombëtare.

2. Paraqitja e ankimit, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk pezullon ekzekutimin e vendimit për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme apo të vendimeve të tjera të miratuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

3. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë shqyrton ankimin, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij.

4. Ankimi administrativ paraqitet në formën e parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Shterimi i ankimit administrativ, sipas këtij neni, është kusht paraprak për kundërshtimin e vendimit në gjykatë.

6. Personi i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

7. Vendimi për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, si dhe akte të tjera të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të ankimohet në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas pikës 6, të këtij neni, vetëm lidhur me konstatimin e dëmit dhe dëmshpërblimin përkatës, që mund të rrjedhë nga ky vendim. Në asnjë rast ankimi në gjykatë, sipas kësaj pike, nuk pezullon zbatimin e vendimit për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

8. Vendimi i gjykatës, sipas pikës 7, të këtij neni, nuk cenon interesat e palëve të treta që veprojnë në mirëbesim, të cilët kanë fituar aksionet, instrumente të tjera të pronësisë, aktivet, të drejtat ose detyrimet e bankës në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dhe nuk ndikon tek aktet administrative të mëpasshme ose transaksionet e përfunduara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, të cilat janë bazuar në vendimin e shfuqizuar.

Neni 69
Kufizime për procedurat e tjera

Pa cenuar të drejtat mbi ekzekutimin e marrëveshjeve të garancisë, të përcaktuara në nenin 53, të këtij ligji, nëse është e nevojshme për zbatimin efektiv të instrumenteve dhe kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, gjykata kompetente, me kërkesë të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në përputhje me objektivin e ndjekur, vendos pezullimin për një periudhë të përshtatshme kohe të çdo procesi gjyqësor, në të cilin një bankë nën procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është ose bëhet palë. Pas përfundimit të afatit të pezullimit të vendosur nga gjykata, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund t'i drejtohet me një kërkesë të re gjykatës për të vendosur një afat të ri pezullimi.

KREU IX
MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI ME SHTETET E TJERA

Neni 70
Marrëveshjet me shtetet e tjera

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me autoritete kompetente të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një shteti tjetër ose me organizata ndërkombëtare, të cilat janë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme ndaj një institucioni që është pjesë e një grupi bankar ose e një grupi financiar që vepron në Republikën e Shqipërisë ose anasjelltas, në mënyrë që të përcaktojnë fushën dhe mënyrën e kryerjes së veprimit në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ndaj një grupi ndërkufitar.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mban komunikim me autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të vendit ku banka mëmë ka një filial ose një degë që konsiderohet me rëndësi për ndërhyrje të jashtëzakonshme, si dhe ka të drejtë të marrë pjesë në kolegjet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me kusht që të zbatohen kërkesa të barasvlershme për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit.

3. Marrëveshjet e bashkëpunimit, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përcaktojnë proceset dhe marrëdhëniet midis autoriteteve pjesëmarrëse për shkëmbimin e informacioneve të nevojshme, si dhe për bashkëpunimin në përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e disa ose të gjitha kompetencave të mëposhtme:

a) përgatitjen e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe kërkesa të ngjashme në bazë të legjislacionit të vendeve përkatëse;

b) vlerësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka dhe në grupe bankare, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe kërkesa të ngjashme në bazë të legjislacionit të vendeve përkatëse;

c) ushtrimin e kompetencave për të trajtuar ose eliminuar pengesat ndaj aftësisë për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe kompetencat e ngjashme në bazë të legjislacionit të vendeve të tjera përkatëse;

ç) përdorimin e masave të ndërhyrjes së hershme, në përputhje me këtë ligj dhe kompetenca të ngjashme në bazë të legjislacionit të vendeve të tjera përkatëse;

d) përdorimin e instrumenteve dhe ushtrimin e kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe kompetenca të ngjashme, të cilat ushtrohen nga autoritetet përkatëse të vendeve të tjera.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vë në dijeni Ministrinë e Financave, kur këto informacione lidhen me një vendim ose çështje që kërkon njoftimin, konsultimin ose pëlqimin e saj ose që mund të kërkojë mbështetje financiare publike të jashtëzakonshme.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme u jep informacion konfidencial, përfshirë planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, autoriteteve të vendeve të tjera përkatëse vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ka një kërkesë zyrtare për informacion nga ana e autoritetit të vendit të huaj;

b) autoritetet e vendeve të tjera u nënshtrohen kërkesave dhe standardeve të sekretit profesional që konsiderohet se janë të paktën të barasvlershme, sipas vlerësimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, dhe nuk bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 67 të këtij ligji.

Trajtimi dhe transmetimi i të dhënave personale tek autoritetet e vendeve të tjera kryhet nëse nuk bie në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

c) informacioni është i nevojshëm për autoritetet e vendeve të tjera të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, funksionet e të cilave, në bazë të legjislacionit të tyre, janë të krahasueshme me funksionet në bazë të këtij ligji;

ç) informacioni nuk do të përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveç atij të parashikuar në marrëveshjet e bashkëpunimit.

6. Kur informacioni konfidencial është kërkuar ose ka ardhur nga një vend tjetër, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Ministria e Financave nuk ua japin këtë informacion autoriteteve të vendeve të tjera nëse nuk plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) autoriteti përkatës, prej nga ka ardhur informacioni (autoriteti i origjinës), jep pëlqimin për dhënien e informacionit;

b) informacioni jepet vetëm për qëllimet e lejuara nga autoriteti i origjinës.

7. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ka të drejtë, nëse e vlerëson të arsyeshme dhe duke marrë parasysh pasojat në stabilitetin financiar, të pranojë zbatimin për raste të caktuara të vendimit të një autoriteti të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një vendi tjetër edhe kur nuk ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këtë autoritet.

KREU X
FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Neni 71
“Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” themelohet dhe përdoret për qëllime të zbatimit të këtij ligji.

2. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore, të miratuara nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim.

3. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” nuk ka personalitet juridik.

4. Çdo pretendim në lidhje me “Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme” i drejtohet Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

5. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” nuk mund të bllokohet, të sekuestrohet apo t’i nënshtrohet ekzekutimit të detyrueshëm.

Neni 72
Burimet financiare të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”

1. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” përbëhet nga burimet financiare të mëposhtme:

a) kontributet vjetore të paguara nga bankat;

b) kontributet e jashtëzakonshme të paguara nga bankat;

c) huat, subvencionet dhe donacionet. Huat mund të garantohen duke përdorur aktivet e tashme dhe/ose të ardhshme të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

ç)të ardhura nga administrimi i mjeteve financiare të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”;

d) të ardhurat nga rimarrja e fondeve të përdorura gjatë zbatimit të kompetencave dhe instrumenteve të parashikuara në këtë ligj;

dh) gjobat e mbledhura nga zbatimi i sanksioneve të përcaktuara në nenin 81 të këtij ligji;

e) instrumente të tjera financiare, të përcaktuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Nëse burimet dhe mjetet financiare, të siguruara sipas pikës 1, të këtij neni, vlerësohen se janë të pamjaftueshme nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me kërkesë të këtij të fundit, burimet dhe mjetet financiare mund të plotësohen nëpërmjet huas nga Buxheti i Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Masa e huas që do të jepet përcaktohet në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit financiar, si dhe të jetë në përputhje me qëndrueshmërinë e financave publike, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë. Normat e interesit të huas në çdo rast nuk duhet të jenë më të larta se normat e interesit të titujve, me maturitet të krahasueshëm, të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë e të tregtueshme në Republikën e Shqipërisë. “Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” nuk mund të plotësohet nëpërmjet huas nga Buxheti i Shtetit për rastet e kompensimit të aksionarëve, sipas pikës 9, të nenit 68, të këtij ligji.

3. Agjencia e Sigurimit të Depozitave nënshkruan marrëveshjet e huas për llogari të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”. Shlyerja e kësaj huaje bëhet nëpërmjet burimeve financiare, të parashikuara në pikën 1, të nenit 72, të këtij ligji, dhe nuk mund të shtrihet mbi pasuritë dhe fondet e tjera që administron apo ka në pronësi Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Neni 73
Administrimi i "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme"

1. "Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme" administrohet në përputhje me politikën e administrimit të mjeteve financiare të fondit, të miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me propozimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Politika e investimit përcakton procedurat, kriteret dhe kufijtë e përqendrimit dhe maturitetit, të zbatueshme nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në investimin e mjeteve financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

2. Administrimi i "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" duhet të garantojë sigurinë e mjeteve financiare, likuiditetet të lartë dhe profil të ulët rreziku.

3. Mjetet financiare të fondit investohen vetëm në:

a) tituj borxhi të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë, në lekë dhe në monedhë të huaj;

b) tituj borxhi të emetuar nga qeveritë dhe bankat qendrore, të cilat vlerësohen si të investueshme nga agjenci për vlerësimin e riskut, të njohura ndërkombëtarisht;

c) depozita ose tituj borxhi të emetuar nga institucione financiare ndërkombëtare, të cilat vlerësohen si të investueshme nga agjenci për vlerësimin e rrezikut, të njohura ndërkombëtarisht;

ç) depozita në Bankën e Shqipërisë.

4. Agjencia e Sigurimit të Depozitave, me qëllim sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga ky ligj, krahas veprimeve në tregjet financiare, mund t'i shesë Bankës së Shqipërisë ose Ministrisë së Financave, me detyrim riblerjeje, titujt në të cilët janë investuar mjetet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

5. Agjencia e Sigurimit të Depozitave hyn në marrëveshje me Bankën e Shqipërisë dhe/ose Ministrinë e Financave për qëllimet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni.

6. Agjencia e Sigurimit të Depozitave për administrimin e mjeteve financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" merr një pagesë vjetore për rimbursimin e kostove në lidhje me administrimin e këtij fondi. Masa dhe mënyra e pagesës përcaktohen nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me propozimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Neni 74
Përdorimi i mjeteve financiare nga "Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme"

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përdor mjetet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" për qëllimet e mëposhtme:

a) për të garantuar aktivet ose pasivet e bankës, e cila është në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, filialeve të saj, bankës urë apo të një shoqërie për administrimin e aktiveve;

b) për t'i dhënë likuiditet bankës, e cila është në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, filialeve të saj, një banke urë apo një shoqërie për administrimin e aktiveve;

c) për të blerë aktivet e bankës, e cila është në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

ç)për të kontribuar në kapital dhe për të siguruar fondet e tjera të nevojshme për një bankë urë apo një shoqëri për administrimin e aktiveve;

d) për t'i paguar kompensim aksionarëve ose kreditorëve, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji;

dh) për t'i kompensuar bankës, e cila është në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme humbjet e pambuluara që lindin për shkak të përjashtimit të detyrimeve të pranuara të kreditorëve, të caktuara nga zbatimi i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, në përputhje me pikën 1, të nenit 31, të këtij ligji;

e) për të ndërmarrë ndonjë kombinim të veprimeve të përmendura në shkronjat "a" deri në "dh" të kësaj pike;

ë) për të paguar kostot e arsyeshme të pësuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në lidhje me zbatimin e instrumenteve apo kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nëse nuk bëhet kompensimi në përputhje me pikën 4, të nenit 25, të këtij ligji;

f) për mbulimin e shpenzimeve për administrimin e "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

g) për shlyerjen e detyrimeve dhe huave të marra, në përputhje me nenin 72, të këtij ligji;

gj) për çdo pagesë dëmshpërblimi, sipas vendimit administrativ ose gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, gjatë zbatimit të instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar, mund të përdorë mjetet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" edhe për të ndërmarrë veprime të parashikuara në shkronjat "a" deri në "ë", të pikës 1, këtij neni, në lidhje me blerësin.

3. Mjetet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" nuk përdoren për të përthithur në mënyrë të drejtpërdrejtë humbjet ose rikapitalizimin e bankës. Në rast se gjatë përdorimit të mjeteve financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", për qëllimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, rezulton se një pjesë e humbjeve të bankës përthithen në mënyrë indirekte nga ky fond, zbatohen parimet që rregullojnë përdorimin e "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme", të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme urdhëron Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për transferimin e mjeteve të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" në llogarinë përkatëse në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e shkronjave "a" deri në "ë", të pikës 1, të këtij neni.

Neni 75
Niveli i "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme"

1. "Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme" duhet të arrijë nivelin prej 0,5 për qind të totalit të detyrimeve, të llogaritura si diferenca ndërmjet aktiveve dhe kapitalit të të gjitha bankave të licencuara në Republikën e Shqipërisë. Afati i plotësimit të shumës është 10 vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor metodologjinë e llogaritjes së këtij niveli.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund ta zgjasë deri në katër vjet afatin fillestar, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nëse mjetet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" janë përdorur në vlerë progresive me më tepër se 0,25 për qind të totalit të detyrimeve, të llogaritura si diferenca ndërmjet aktiveve dhe kapitalit të të gjitha bankave të sistemit.

3. Në rastin kur pas plotësimit të nivelit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, mjetet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" zvogëlohen, atëherë rifillon mbledhja e kontributeve të bankave, në përputhje me nenin 72, të këtij ligji, derisa të arrihet niveli i përmendur në pikën 1 të këtij neni.

4. Në rastin kur pas plotësimit të nivelit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, mjetet financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" bien nën vlerën e dy të tretave të nivelit referuar pikës 1, të këtij neni, kontributi caktohet në një nivel që lejon arritjen e nivelit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, brenda gjashtë viteve.

Neni 76
Kontributet vjetore

1. Bankat paguajnë në llogarinë e "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" në Bankën e Shqipërisë kontributet vjetore të përllogaritura nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor metodologjinë e llogaritjes së kontributit vjetor të bankave dhe mënyrën e pagesës së tij.

3. Agjencia e Sigurimit të Depozitave u konfirmon bankave marrjen e pagesës së kontributeve vjetore.

Neni 77
Kontributet e jashtëzakonshme

1. Në rastet kur mjetet financiare në dispozicion të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" nuk janë të mjaftueshme për të përthithur humbjet, kostot dhe shpenzimet e tjera, bankat paguajnë në llogarinë e këtij fondi kontribute të jashtëzakonshme, sipas urdhrit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Kontributi i jashtëzakonshëm përllogaritet përpjesëtimisht për secilën bankë mbi vlerën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 76, të këtij ligji, dhe nuk mund të tejkalojë më shumë se trefishin e kontributit vjetor të fundit, të paguar nga secila bankë.

3. Kontributi i jashtëzakonshëm paguhet brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

4. Agjencia e Sigurimit të Depozitave u konfirmon bankave marrjen e pagesës së kontributeve të jashtëzakonshme.

5. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, me kërkesë të bankës, mund të vendosë pezullimin tërësisht ose pjesërisht të pagesës së kontributit të

jashtëzakonshëm nga kjo bankë për arsye të ruajtjes së likuiditetit ose aftësisë paguese të saj. Ky pezullim nuk duhet të tejkalojë 180 ditë, por përjashtimisht mund të rinovohet vetëm një herë për të njëjtin afat. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme njofton Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për pezullimin e zbatuar, sipas kësaj pike.

6. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton me akt nënligjor rrethanat dhe kushtet në të cilat zbatohet pika 5 e këtij neni.

Neni 78

Përdorimi i fondit të kompensimit të depozitave gjatë kryerjes së ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rastet kur zbaton instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim që depozituesit të vazhdojnë të kenë mundësi t'i përdorin depozitat e tyre, urdhëron Agjencinë e Sigurimit të Depozitave të transferojë nga fondi i kompensimit të depozitave në banka, në llogarinë përkatëse pranë Bankës së Shqipërisë:

a) shumën me të cilën depozitat e siguruara do të ishin zhvlerësuar për të përthithur humbjet, në rast se do të trajtoheshin njëlloj si kreditorët e tjerë të së njëjtës radhë shlyerjeje të detyrimeve, gjatë zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 30, të këtij ligji;

b) shumën e humbjeve që depozitat e siguruara do të kishin pësuar, në rast se do të trajtoheshin njëlloj si kreditorët e tjerë të së njëjtës radhë shlyerjeje të detyrimeve, gjatë zbatimit të instrumenteve të tjera, të ndryshme nga rikapitalizimi nga brenda.

2. Në çdo rast, shuma e pjesëmarrjes së fondit të kompensimit të depozitave gjatë kryerjes së procedurave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e humbjeve në rastin e procedurave të likuidimit të detyruar.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në çdo rast merr mendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave përpara se të urdhërojë përdorimin e fondit të kompensimit të depozitave në banka, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave vendos për kthimin e fondit të kompensimit të depozitave në mjete likuide dhe transferimin e tij në llogarinë përkatëse në Bankën e Shqipërisë.

5. Kur zbatohet instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, në përputhje me shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 30, të këtij ligji, nuk përdoren mjetet e fondit të kompensimit të depozitave, për të rikapitalizuar bankën, në të cilën po zbatohet instrumenti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose bankën urë.

6. Kur vlerësimi i përmendur në nenin 57, të këtij ligji, përcakton se kontributi i fondit të kompensimit të depozitave do të ishte më i madh sesa humbjet neto në procedurat e likuidimit të detyruar, Agjencia e Sigurimit të Depozitave rimbursohet për diferencën përkatëse nga "Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme", në përputhje me nenin 58 të këtij ligji.

7. Kur tërësia e depozitave të siguruesshme të bankës nën procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme transferohet te një subjekt juridik nëpërmjet instrumentit të shitjes së aktivitetit tregtar ose bankës urë, depozituesit nuk gëzojnë të drejtën të ngrenë asnjë pretendim ndaj Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në lidhje me çdo pjesë të depozitave të tyre, të cilat nuk transferohen nga banka nën procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me kusht që shuma totale e transferuar të jetë e barabartë me nivelin maksimal të mbulimit total, të parashikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

8. Kur fondi i kompensimit të depozitave është përdorur në përputhje me këtë nen dhe, si rrjedhojë, ky fond është zvogëluar, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ka të drejtë të ushtrojë kompetencat për rritjen e primit ose pagimin e primit tremujor të pagueshëm përpara afatit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimin e depozitave.

9. Gjatë kryerjes së procedurave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kontributi i fondit të kompensimit të depozitave, me qëllim të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk mund të jetë më i madh se 50 për qind e fondit të kompensimit të depozitave në banka, në momentin e marrjes së urdhrit nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe, në çdo rast, jo më shumë se humbjet që fondi i kompensimit të depozitave në banka do të kishte pësuar në procedurat e likuidimit të detyruar.

Neni 79
Administrimi i fondeve nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave

1. Agjencia e Sigurimit të Depozitave mban llogari dhe regjistra financiarë të veçantë për "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme", me qëllim që në çdo kohë të pasqyrohet qartë dhe saktë gjendja financiare e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe me standardet ndërkombëtare.

2. Agjencia e Sigurimit të Depozitave përgatit raportin dhe llogaritë financiare për administrimin e këtij fondi në fund të çdo viti financiar.

3. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

4. Pasqyrat financiare vjetore të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" certifikohen nga auditues të jashtëm të specializuar, që miratohen nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin e depozitave, pas konsultimit me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

5. Raporti mbi veprimtarinë vjetore të investimit, si dhe pasqyrat financiare të audituara për administrimin e "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme" i paraqiten Bankës së Shqipërisë jo më vonë se tre muaj nga mbyllja e vitit financiar.

6. Agjencia e Sigurimit të Depozitave publikon raportin mbi veprimtarinë vjetore të investimit, si dhe pasqyrat financiare të audituara për administrimin e fondit në faqen e saj të internetit.

KREU XI
SANKSIONET

Neni 80
Rastet e vendosjes së sanksioneve

1. Banka e Shqipërisë vendos sanksione ndaj bankës, administratorëve apo punonjësve të saj, kur konstaton se banka:

a) nuk harton dhe përditëson planet e rimëkëmbjes;

b) nuk jep informacionin dhe të dhënat e nevojshme për procesin e hartimit e të përditësimit të planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

c) nuk njofton Autoritetin Mbikëqyrës mbi marrëveshjet për mbështetje financiare brenda grupit;

ç) nuk mban ose nuk përditëson listën e kontratave financiare;

d) nuk dorëzon brenda afatit kohor një propozim të masave për heqjen e pengesave;

dh) nuk dorëzon brenda afatit kohor një plan, në përputhje me vendimin e dhënë nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

e) nuk arrin të heqë pengesat për zbatimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës ose kur, brenda afatit kohor të specifikuar, nuk arrin të dorëzojë një plan, në përputhje me masat e kërkuara, ose nuk vepron në përputhje me një vendim të miratuar sipas nenit 65 të këtij ligji;

ë) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 64, të këtij ligji, nuk e njofton Bankën e Shqipërisë, ku çmon se ajo plotëson ndonjë nga kushtet e përmendura në pikën 2, të nenit 22, të këtij ligji;

f) nuk harton brenda afateve të parashikuara në nenin 39, të këtij ligji, planin për riorganizimin e aktivitetit tregtar ose kur përmbajtja e planit nuk është në përputhje me kërkesat e aktit nënligjor të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

g) apo ndonjë anëtar i të njëjtit grup nuk vepron, në përputhje me kërkesat e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, sipas parashikimeve të këtij ligji;

gj) nuk paguan kontribute vjetore në "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

h) nuk paguan kontribute të jashtëzakonshme në "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

i) vepron në kundërshtim me aktet nënligjore, të miratuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në zbatim të këtij ligji.

2. Për rastet e shkeljeve të përcaktuara në shkronjat "gj" dhe "h", të pikës 1, të këtij neni, vendosja e sanksioneve bëhet me propozimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Neni 81
Sanksionet

1. Në rast se konstatohen shkeljet e parashikuara në nenin 80, të këtij ligji, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton sanksionet e mëposhtme:

a) urdhëron bankën, administratorët e bankës apo punonjësin e bankës, përgjegjës për shkeljen, të ndërpresë veprimet në kundërvajtje, si dhe të ndreqë shkeljen e konstatuar;

b) urdhëron pezullimin e përkohshëm nga ushtrimi i funksionit për administratorët e bankës apo për çdo punonjës tjetër të bankës, përgjegjës për shkeljen;

c) vendos gjobë për bankën, e cila ka kryer shkelje, nga 1 000 000.00 lekë deri në vlerën më të madhe midis 10 000 000.00 lekë dhe 10 për qind të fitimit të bankës, bazuar në pasqyrat financiare të vitit të mëparshëm;

ç) vendos gjobë për administratorët e bankës apo punonjësin, përgjegjës për shkeljen, nga 100 000.00 lekë dhe deri në 1 000 000.00 lekë;

d) vendos gjobë për personin përgjegjës për shkeljen deri në dyfishin e shumës së përfitimit të nxjerrë nga shkelja, kur ky përfitim mund të identifikohet;

Gjobat janë tituj ekzekutivë dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet zyra e përmbarimit.

2. Në rast të vonesës në pagimin e kontributeve vjetore ose të jashtëzakonshme, banka paguan në "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme" interesa të barabartë me kredinë për mbështetje me likuiditet të Bankës së Shqipërisë, për periudhën deri në pagimin e kontributit.

Neni 82

Aplikimi efektiv i sanksioneve

Gjatë përcaktimit të llojit të sanksioneve administrative ose masave të tjera administrative dhe nivelit të gjobave administrative, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë aty ku është e mundur:

a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;

b) shkallën e përgjegjësisë së individit ose personit juridik përgjegjës;

c) gjendjen financiare të individit ose personit juridik përgjegjës;

ç) shumën e fitimeve ose humbjeve të shmangura nga individi ose personi juridik përgjegjës, për aq sa ato mund të përcaktohen;

d) humbjet për palët e treta, të shkaktuara nga shkelja, për aq sa ato mund të përcaktohen;

dh) nivelin e bashkëpunimit të individit ose personit juridik përgjegjës me Autoritetin Mbikëqyrës dhe Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

e) shkeljet e mëparshme nga ana e individit ose personit juridik përgjegjës;

ë) pasojat e mundshme sistemike të shkeljes.

Neni 83

Publikimi i sanksioneve administrative

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme publikon në faqen zyrtare të internetit sanksionet administrative të vendosura për shkelje të dispozitave të këtij ligji. Publikimi bëhet menjëherë pasi personi, ndaj të cilit është vendosur sanksioni, të jetë informuar për atë sanksion, duke përfshirë informacione mbi llojin e natyrën e shkeljes dhe identitetin e individit apo personit juridik, mbi të cilin është vendosur sanksioni.

2. Në rastin e publikimit të sanksioneve, kundër të cilave është bërë ankesë, Autoriteti Mbikëqyrës dhe Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, publikojnë në faqet e tyre zyrtare të internetit informacionin mbi statusin e asaj ankese dhe rezultatin e saj.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme publikon sanksionet e vendosura në mënyrë anonime (duke fshehur të dhënat identifikuese), në një nga rrethanat e mëposhtme:

a) kur sanksioni është vendosur ndaj një individi dhe publikimi i të dhënave personale vlerësohet të jetë jopropocional në lidhje me shkeljen;

b) kur publikimi rrezikon stabilitetin e tregjeve financiare ose një hetim penal që është në vazhdim;

c) kur publikimi shkakton dëme të konsiderueshme, për aq sa mund të përcaktohet për bankat ose individët e përfshirë.

Për rrethanat e parashikuara në këtë pikë publikimi i të dhënave mund të shtyhet për një periudhë të arsyeshme kohore, në qoftë se është e mundur të parashikohet se arsyet për publikim anonim do të pushojnë së ekzistuari brenda asaj periudhe.

4. Publikimi në përputhje me këtë nen qëndron në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për një periudhë të paktën pesëvjeçare. Të dhënat personale, që përfshihen në publikim, mbahen në faqen zyrtare të Autoritetit Mbikëqyrës dhe Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për periudhën e cila është e nevojshme, në përputhje me rregullat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU XII
ANKIMI ADMINISTRATIV DHE GJYQËSOR

Neni 84
Ankimi administrativ

1. Çdo person fizik ose juridik, i cili pretendon se të drejtat apo interesat e ligjshëm të tij janë cenuar nga akte administrative të nxjerra në zbatim të dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kryejë ankim administrativ, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e aktit. Ankimi administrativ i drejtohet:

a) Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në rastet kur akti administrativ është nxjerrë nga ky organ administrativ;

b) Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, në rastet kur akti administrativ është nxjerrë nga vetë Guvernatori ose nga organe të tjera të Bankës së Shqipërisë.

2. Paraqitja e ankimit, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk pezullon ekzekutimin e vendimit për vendosjen e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të vendimeve të tjera të miratuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

3. Ankimi administrativ paraqitet në formën dhe shqyrtohet brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

4. Realizimi i ankimit administrativ, sipas këtij neni, është kusht paraprak për kundërshtimin e vendimit në gjykatë.

Neni 85
Ankimi gjyqësor

1. Personi i përcaktuar në pikën 1, të nenit 84, të këtij ligji, ka të drejtë të paraqesë ankim gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, në përfundim të procesit të ankimit administrativ.

2. Ankimi gjyqësor, sipas pikës 1, të këtij neni, paraqitet sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU XIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 86
Mbrojtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës

1. Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, administratorët dhe çdo punonjës i saj, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, strukturat dhe punonjësit e saj nuk janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve edhe në rastet kur janë larguar nga kjo detyrë nga veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe përmbushjes së përgjegjësive të tyre ligjore, të parashikuara në këtë ligj.

2. Parashikimet e pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohen në rast se personat e sipërpërmendur kanë vepruar me keqbesim ose në përfitim të tyre, duke mos respektuar qëllimisht detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Në këtë rast, ata detyrohen të përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë ose juridikë privatë.

3. Dispozitat e legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore nuk zbatohen për të përcaktuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të Bankës së Shqipërisë, si dhe të organeve apo punonjësve të saj.

Neni 87
Aktet në zbatim të ligjit

Ngarkohet Banka e Shqipërisë me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 88
Dispozitë kalimtare

1. Bankat fillojnë të paguajnë kontributin e tyre në "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme" brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pas njoftimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Banka e Shqipërisë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi të këtij ligji, merr masa për krijimin e njësisë organizative, sipas nenit 6 të ligjit.

Neni 89
Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji.

2. Pika 3, e nenit 6, të këtij ligji, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9936, datë 9.1.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 392 lekë